



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 166 i Vendimit**

**V E N D I M**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi  
Ervin Pupe  
Irir Panda**

**Kryesues  
Anëtar  
Anëtar**

Në datën 22.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Bashkia Tiranë

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.1320, datë 30.03.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.2674, datë 10.10.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 449, 479/a të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Shoqëria “Derveni 1” sh.p.k

**PADITUR:** Bashkia Tiranë

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Shoqëria “Derveni 1” sh.p.k, rezulton se ka rikonstruktuar rrugës “Fabrika e Qelqit” dhe pretendon se nuk është paguar për punë e kryer.

2. Nga ana e palës së paditur Bashkia Tiranë, pranohet se detyrimi nuk është shlyer por nuk duhet të kryet prej saj por prej Fondit të Zhvillimi të Rajoneve.

3. Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr.1320, datë 30.03.2017 ka vendosur:

Pranimin e padisë.

Detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë ti paguajë palës paditëse shumën prej 13.708.990 (trembëdhjetë milion e shtatëqind e tetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) lekë, kamatëvonesa në shumën 517.887 (pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë të përlllogaritura deri në datën përpilimit të aktit të ekspertimit datë 15.03.2017, si dhe kamatëvonesat ligjore prej kësaj date deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

5. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.2674, datë 10.10.2019 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.1320, datë 30.03.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

6. Më datë **13.01.2020** Bashkia Tiranë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Ashtu sikurse kemi parashtruar edhe në rekurs, gjykatat nuk kanë marrë parasysh faktin se projekti i rikonstruksionit të rrugës “Fabrika e Qelqit” ka qenë një bashkëfinancim midis Bashkisë Tiranë dhe Fondit të Zhvillimi të Rajoneve.*
- *Kemi provuar se Bashkia Tiranë ka një konrrespondencë me Fondin e Zhvillimit të Rajoneve, e cila provon se mos shlyerja e detyrimeve nuk ka ardhur si pasojë e mos veprimit të Bashkisë Tiranë, por si pasojë e mos financimit nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.*
- *Përmbaruesi Gjyqësor me shkresën nr.5020 datë 24.11.2019 ka filluar procedurën e ekzekutimit të këtyre vendimeve.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda finaciare.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

7. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

10. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

11. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të

formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Bashkia Tiranë, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

15. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Bashkia Tiranë, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

16. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Bashkia Tiranë, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

17. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Bashkia Tiranë kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

18. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Bashkia Tiranë nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Bashkia Tiranë.

19. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

20. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Bashkia Tiranë, për pezullimin e

ekzekutimit të vendimit nr.1320, datë 30.03.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.2674, datë 10.10.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “*Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

### **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.1320, datë 30.03.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.2674, datë 10.10.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Bashkia Tiranë.

**Tiranë, më datë 22.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 172 i Vendimit**

**V E N D I M**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi  
Ervin Pupe  
Irir Panda**

**Kryesues  
Anëtar  
Anëtar**

Në datën 22.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Bashkia Tiranë

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.4796, datë 18.06.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.2446, datë 18.09.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 449, 479/a të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Avni Muça

**PADITUR:** Bashkia Tiranë

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Avni Muça, pretendon se është pronar një sipërfaqje 36 m2 truall, me nr.9/128, ZK 8180, vol 12, faqe 127.

2. Nga ana e palës së paditur Bashkia Tiranë, pretendohet se kjo sipërfaqe është shpronësuar faktikisht dhe nuk është kryer shpërblimi përkatës.

3. Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

**4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr.4796, datë 18.06.2016 ka vendosur:

Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë së paraqitur nga paditësi Avni Muça.

Detyrimin e palëve të paditur Bashkia Tiranë, Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Punëve të Brendshme që të shpronësojë për interes publik pasurinë nr.9/128, ZK 8180, vol 12, faqe 127 e llojit truall me sipërfaqe 39 m2 me vendndodhje rruga “Ali Asllani ( Pasho Vasa)” Tiranë, e regjistruar në ZVRPP Tiranë në emër të paditësit Avni Muça.

Detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë të dëmshpërblejë paditësin Avni Muça në vlerën 1.476.000 lekë (një milion e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë), për pronësin e pashpronësuar nr.9/128, ZK 8180, vol 12, faqe 127 e llojit truall me sipërfaqe 39 m2, e regjistruar në ZVRPP Tiranë.

Detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë të dëmshpërblejë paditësin Avni Muça për dëmin e shkaktuar në prishjen e murit rrethues në vlerën 225.933 (dyqind e njëzetë pesë mijë e nëntëqind e tridhjetë e tre) lekë.

Detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë të dëmshpërblejë paditësin Avni Muça për dëmin e shkaktuar nga mospërmbushja në kohë të detyrimit për pagimin e vlerës së shpronësimit sipas VKM nr.768 datë 16.09.2015, vlerën 4.720 (katër mijë e shtatëqind e njëzetë) lekë, si dhe interesat ditore mbi këtë vlerë në shumën 6.2 lekë/ditë deri në ekzekutimin e këtij vendimi.

Rrëzimin e kërkesë padisë për pjesën tjetër të objektit, si të pabazuar në ligj e në prova.

**5. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.2446, datë 18.09.2019 ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr.4796, datë 18.06.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në këtë mënyrë:

Pranimin e pjesshëm të padisë së paditësit Avni Muça.

Detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë:

- T’i paguajë paditësit Avni Muça shumën 1.082.124 lekë (një milion e tetëdhjetë e dy mijë e njëqind e njëzetë e katër), si dëm pasuror shkaktuar ngazënia faktikee pasurisë truall me sipërfaqe 36 m2, prekur nga rikonstruksioni i rrugës “Pasho Hysa” Tiranë, truall i regjistruar pranë ZVRPP Tiranë në pronësi të Avni Muça në pasurinë nr.9/128, ZK 8180, vol 12, faqe 127 e llojit truall.
- Të kryejë procedurat për regjistrimin e ri të pasurisë truall prej 36m2 në favor të Bashkisë Tiranë.

Detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë të dëmshpërblejë paditësin Avni Muça për dëmin e shkaktuar nga mospërmbushja në kohë të detyrimit për pagimin e vlerës së shpronësimit sipas VKM nr.768 datë 16.09.2015, vlerën 4.720 (katër mijë e shtatëqind e njëzetë) lekë, si dhe interesat ditore mbi këtë vlerë në shumën 6.2 lekë/ditë, deri në ekzekutimin e këtij vendimi.

Rrëzimin e padisë sa i takon pjesës tjetër të kërtimeve.

6. Më datë **23.01.2020** Bashkia Tiranë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Bashkia Tiranë ka depozituar rekursin me nr.prot. 413113 datë 31.10.2019.*
- *Përmbaruesi me shkresën nr.13354 datë 15.10.2019 lajmëron ekzekutimin vullnetar.*
- *Mendojmë se vendimet e gjykatave nuk janë të drejta dhe të bazuara në ligj në lidhje me objektin e padisë, mbasi paditësja nuk paraqiti asnjë provë që të provonte pretendimet e saj dhe të kundërshtonte argumentat tona.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda për buxhetin e Bashkisë Tiranë, për shkak të vlerës relativisht të lartë.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

7. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

10. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor,



respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

11. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Bashkia Tiranë, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

15. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Bashkia Tiranë, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

16. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Bashkia Tiranë, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

17. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Bashkia Tiranë kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e

shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

18. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Bashkia Tiranë nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Bashkia Tiranë.

19. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

20. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Bashkia Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.4796, datë 18.06.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.2446, datë 18.09.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

## **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

## **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.4796, datë 18.06.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.2446, datë 18.09.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Bashkia Tiranë.

**Tiranë, më datë 22.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr.176 i Vendimit**

**V E N D I M  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi  
Ervin Pupe  
Ilir Panda**

**Kryesues  
Anëtar  
Anëtar**

Në datën 22.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Komisioni i Prokurimit Publik

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.3005, datë 12.11.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 449, 479 gërma “a”, 483, 484 të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Shoqëria “Victoria Invest” sh.p.k

**PADITUR:** Komisioni i Prokurimit Publik  
Bashkia Tiranë

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Shoqëria “Victoria Invest” sh.p.k, ka marrë pjesë në tenderin e zhvilluar nga Bashkia Tiranë për “shërbim i pastrimit të zonës Tirana III”.

2. Nga ana e palës së paditur Bashkia Tiranë është njoftuar pala paditëse se është skualifikuar oferta e saj dhe në datë 25.10.2017 ka paraqitur ankim po pranë këtij institucioni, i cili nuk ka pranuar ankesën.

3. Në vijim paditësi në datë 10.11.2017 ka ndjekur ankimin administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik, i cili ka bashkuar disa ankime edhe të operatorëve të tjerë dhe me vendimin nr.781/2017 ka rrëzuar ankimin e palës së paditëse dhe ndërkohë ka pranuar ankimin për disa operator të tjerë.

4. Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

**5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr.754, datë 02.03.2018 ka vendosur:

Pranimin e kërkesë padisë administrative me nr.6045/953 datë 19.12.2017 regjistrimi.

Shfuqizimin e pjeshëm të veprimit administrativ, vendimit me nr.38927/2 prot., datë 01.11.2017 të kryer prej palës së paditur Bashkia Tiranë me cilësinë e autoritetit kontraktor për skualifikimin e operatorit ekonomik, palë paditëse shoqëria tregtare “Victoria Invest” sh.p.k.

Shfuqizimin e pjeshëm të veprimit administrativ, vendimit me nr.781/2017 të kryer prej palës së paditur Komisioni i Prokurimit Publik, për sa i drejtohet operatorit ekonomik palë paditëse shoqëria tregtare “Victoria Invest” sh.p.k.

**6. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.3005, datë 12.11.2019 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.754, datë 02.03.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

7. Më datë **29.01.2020** Komisioni i Prokurimit Publik, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtrojnë sa vijon:

- *Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është marrë në zbatim të keq të ligjit dhe në shkelje të normave proceduriale.*
- *Gjykata nuk ka marrë në shqyrtim provat e depozituara në senacë gjyqësore dhe nuk ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithëanshëm, si dhe nuk ka konstatuar në mënyrë të saktë të gjendjes faktike.*
- *Gjykata Administrative e Apelit ka lënë në fuqi analizën e shkallës së parë duke vlerësuar të panevojshëm një nga kriteret e vendosura nga AK, ndërkohë që kjo fazë procedurale tashmë kishte kaluar dhe operatori ekonomik nuk i kishte kundërshtuar kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda dhe të pariparueshme.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

8. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

9. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

10. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit.”.*

11. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

12. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

13. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të

formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

14. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjesisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

15. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Komisioni i Prokurimit Publik, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

16. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Komisioni i Prokurimit Publik, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

17. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Komisioni i Prokurimit Publik, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

18. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Komisioni i Prokurimit Publik kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

19. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Komisioni i Prokurimit Publik nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Komisioni i Prokurimit Publik.

20. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe

natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

21. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Komisioni i Prokurimit Publik, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.3005, datë 12.11.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “*Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

### **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.3005, datë 12.11.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Komisioni i Prokurimit Publik.

**Tiranë, më datë 22.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr.183 i Vendimit.**

**V E N D I M**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi  
Ervin Pupe  
Irir Panda**

**Kryesues  
Anëtar  
Anëtar**

Në datën 22.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.2591, datë 02.10.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 gërma “a” pika 2 të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Leonard Lalaj

**PADITUR:** Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Leonard Lalaj, ka punuar pranë palës së paditur prej datës 27.07.2005 dhe ka mbajtur disa



funksiione dhe së fund me urdhërin nr.843 datë 17.02.2016 është emëruar “Specialist në Sektorin për Hetimin e krimit Ekonomik e Financiar në Drejtorinë e Përgjithshme për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimet e Rënda në Drejtorinë e Policisë së Shtetit me gradën Nënkomisar”.

2. Nga ana e palës së paditur me shkresën nr. 89/1-L datë 31.01.2017, është refuzuar kërkesa e palës paditëse për dhënien e gradës “Kryekomisar”, me arsyetimin se fitimi i gradës mundësohet vetëm nëpërmjet pjesëmarrjes në konkurim, pas plotësimit të kriterëve përkatëse.

3. Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

**4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr.1237, datë 27.03.2017 ka vendosur:

Pranimin e kërkesë padisë së paraqitur nga paditësi Leonard Lalaj.

Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Policisë së Shtetit që t’i njohë paditësit Leonard Lalaj, gradën policore “Kryekomisar” në përputhje me funksionin Specialist në Sektorin për Hetimin e Korrupsionit në Drejtorinë për Hetimin e Krimit Ekonomik e Financiar në Drejtorinë e Përgjithshme për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimet e Rënda në Drejtorinë e Policisë së Shtetit.

**5. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.2591, datë 02.10.2019 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.1237, datë 27.03.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

6. Më datë **04.02.2020** Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në bazë të nenit 472 të K.Pr.Civile ka ushtruar rekurs pranë Gjykatës së Lartë duke parashtruar shkaqet përkatëse.*
- *I gjithë kuadri ligjor mbi organizimin dhe funksionimin e Policisë, e veçanërisht procedura e ngritjes në gradë, e të kokuurimit për këtë të fundit, është i ndërtuar mbi lidhjen e ngusht detyrë funksionale- gradë.*
- *Akordimi i dy gradave policore nga “Nënkomisar në Kryekomisar” jo vetëm që është një vendim i cili bie në kundërshtim flagrant me loigjin por gjithashtu sjellë injorim total që i bën gjykata procesit të konkurimit në gradë mbi bazën e vjetërsisë në shërbim dhe meritës profesionale që disponon secili punonjës policie.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda financiare dhe të pariparueshme.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

7. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor

të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

10. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

11. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e

tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

15. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

16. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, i cili ka parashtruar argumente lidhur me mos bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe në thelb të qëndrimit të tij ka kërkuar mospranimin e kërkesë si të pabazuar në ligj.

17. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

18. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

19. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar

njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

20. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2591, datë 02.10.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “*Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

### **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2591, datë 02.10.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

**Tiranë, më datë 22.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr.195 i Vendimit**

**V E N D I M  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

<b>Sokol Sadushi</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Ervin Pupe</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Illir Panda</b>	<b>Anëtar</b>

Në datën 22.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë  
Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.2842, datë 31.10.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Sazan Piperi

**PADITUR:** Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë  
Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Sazan Piperi, ka paraqitur pranë DRSSH Korçë kërkesë për pension invaliditeti, pasi ka humbur aftësinë në punë dhe vendimin nr.50 i është caktuar pension invaliditeti, për periudhën 08.01.2001- 31.12.2001.

2. Nga ana e palës së paditur me vendimin nr.1524 datë 03.12.2015 KMCAP Rajonal Korçë, ka vendosur të nxjerrë pa grup invaliditeti paditësin dhe për këtë arsye nuk mund të vijoj të marrë pagesën përkatëse. Vendim ku i lënë në fuqi edhe nga KMCAP Epror Tiranë me vendimin nr.126 datë 24.03.2016 të KMCAP Epror pranë ISSH Tiranë, saktësuar me vendimin nr.126 datë 14.07.2016.

3. Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë**, me vendimin nr.2047 (799), datë 20.11.2018 ka vendosur:

Pranimin e padisë së paditësit Sazan Piperi, palë e paditur Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë, si më poshtë:

Shfuqizimin e vendimit nr.126 datë 24.03.2016 të KMCAP Epror pranë ISSH Tiranë, saktësuar me vendimin nr.126 datë 14.07.2016 për trajtimin e paditësit me pension invaliditeti deri në datën 01.06.2016 si akt jo në përputhje me ligjin.

Shfuqizimin e vendimit nr.50/1 datë 31.10.2016 të DRSSH Korçë për mbylljen e pensionit të invaliditetit të paditësit Sazan Piperi dhe detyrimin e palës së paditur të vijojë pagesën e trajtimit sipas kushteve në momentin e mbylljes së tij.

5. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.2842, datë 31.10.2019 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.2047 (799), datë 20.11.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

6. Më datë **19.02.2020** Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtrohet sa vijon:

- *Vendimi i marrë nga të dy gjykatat është një vendim i marrë në interpretim të gabuar të ligjit.*
- *Paditësi me vendimin nr.50 të DRSSH Korçë i është caktuar pension invaliditeti, pasi është vlerësuar se ka humbur aftësinë në punë për periudhën 08.01.2001- 31.12.2001.*
- *Paditësi është kontrolluar në mënyrë të përsëritur dhe me vendimin nr.1524 datë 03.12.2015 KMCAP Rajonal Korçë, ka vendosur të nxjerrë pa grup invaliditeti paditësin dhe për këtë arsye nuk mund të vijoj të marrë pagesën përkatëse. Vendim ku i lënë në fuqi edhe nga KMCAP Epror Tiranë me vendimin nr.126 datë 24.03.2016 të KMCAP Epror pranë ISSH Tiranë, saktësuar me vendimin nr.126 datë 14.07.2016.*
- *Padija nuk gjen mbështetje ligjore sepse qoftë KMCAP Rajonal dhe KMCAP Epror funksionojnë në bazë të ligjit neni 35 të ligjit nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe ku përcaktohet edhe rruga e ankimit në rast vendimesh të pafavorshme.*
- *Nga interpretimi i kësaj dispozite vendimi i KMCAP Epror është i formës së prerë dhe nuk mund të goditet në gjykatë*
- *Për të gjitha më lartë i kërkojmë Gjykatës së Lartë të pezullojë ekzekutimin e vendimit duke pranuar kërkesën sipas objektit.*

7. Më datë **19.02.2020** Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtrohet sa vijon:

- *Vendimi i marrë nga të dy gjykatat është një vendim i marrë në interpretim të gabuar të ligjit.*
- *Paditësi me vendimin nr.50 të DRSSH Korçë i është caktuar pension invaliditeti, pasi është vlerësuar se ka humbur aftësinë në punë për periudhën 08.01.2001- 31.12.2001.*
- *Paditësi është kontrolluar në mënyrë të përsëritur dhe me vendimin nr.1524 datë 03.12.2015 KMCAP Rajonal Korçë, ka vendosur të nxjerrë pa grup invaliditeti paditësin dhe për këtë arsye nuk mund të vijoj të marrë pagesën përkatëse.*
- *Padija nuk gjen mbështetje ligjore sepse qoftë KMCAP Rajonal dhe KMCAP Epror funksionojnë në bazë të ligjit neni 35 të ligjit nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe ku përcaktohet edhe rruga e ankimit në rast vendimesh të pafavorshme.*
- *Nga interpretimi i kësaj dispozite vendimi i KMCAP Epror është i formës së prerë dhe nuk mund të goditet në gjykatë*
- *Për të gjitha më lartë i kërkojmë Gjykatës së Lartë të pezullojë ekzekutimin e vendimit duke pranuar kërkesën sipas objektit.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

8. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

9. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

10. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit.”.*

11. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe

gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

12. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

13. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

14. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

15. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

16. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

17. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

18. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë kërkon pezullimin e



ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

19. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë.

20. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

21. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2842, datë 31.10.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

## **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “*Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

## **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2842, datë 31.10.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë.

Tiranë, më datë 22.06.2020

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 204 i Vendimit.**

**V E N D I M  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi  
Ervin Pupe  
Irir Panda**

**Kryesues  
Anëtar  
Anëtar**

Në datën 22.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Bashkia Tiranë

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.1883 (1906), datë 04.05.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.2487, datë 19.09.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 449, 479/a të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Eduart Keta

**PADITUR:** Bashkia Tiranë

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se palës paditëse Eduart Keta, pretendon se është pronar i një pasurie të paluajtshme e cila i është marrë nga pala e paditur Bashkia Tiranë, duke mos aplikuar procedurat e shpronësimit.

2. Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

3. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr.1883 (1906), datë 04.05.2017 ka vendosur:  
Pranimin e kërkesë padisë.

Detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë që ti paguajë paditësit Eduart Keta shumë 1.610.180 (një milion e gjashtëqind e dhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë) lekë, si dhe interesat mbi këtë shumë duk ei'u referuar normës së interesit të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë, për bankat e nivelit të dytë për depozitat me afat 1 vjeçar, duke filluar nga data 01.01.2004 e deri ekzekutimin e këtij vendimi.

4. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.2487, datë 19.09.2019 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.1883 (1906), datë 04.05.2017 Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

5. Më datë **12.03.2020** Bashkia Tiranë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Mendojmë se vendimet janë marrë në zbatim të gabuar të ligjit material.*
- *Gjykata në shkelje të ligjit material nuk ka konstatuar parashkrimin e të drejtës së ngritjes së padisë objekt gjykimi.*
- *Nuk mund të kërkohet shpërblim i dëmit referuar nenit 608 e vijues të Kodit Civile, pasi mungon paligjshmëria e veprimit të Bashkisë Tiranë si dhe mungon elementi i fajësisë.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda në buxhetin e Bashkisë Tiranë.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

a) *ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose*

b) *pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Bashkia Tiranë, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

14. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Bashkia Tiranë, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

15. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën

e paraqitur nga pala kërkuese Bashkia Tiranë, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

16. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Bashkia Tiranë kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

17. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Bashkia Tiranë nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Bashkia Tiranë.

18. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

19. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Bashkia Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.1883 (1906), datë 04.05.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.2487, datë 19.09.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

## **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile

## **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.1883 (1906), datë 04.05.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.2487, datë 19.09.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Bashkia Tiranë.

**Tiranë, më datë 22.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr.209 i Vendimit.**

**V E N D I M  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

<b>Sokol Sadushi</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Ervin Pupe</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Ilir Panda</b>	<b>Anëtar</b>

Në datën 22.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Bashkia Maliq

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.3272, datë 18.12.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Aleks Nakoleci

**PADITUR:** Bashkia Maliq

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Aleks Nakoleci, ka punuar pranë palës së paditur prej 2005 në disa pozicione të ndryshme pune në ish Komunën Vreshtas.

2. Nga ana e palës së paditur Bashkia Maliq me urdhërin nr.114 datë 30.09.2015 është ndërprerë marrëdhënia e punës me palën paditëse dhe marrëdhëniet financiare po në këtë datë.

3. Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë**, me vendimin nr. 133 (68), datë 22.02.2016 ka vendosur:

Pranimin pjesërisht të padisë.

Detyrimin e palës së paditur Bashkia Maliq, ti paguajë paditësit Aleks Nakoleci shpërblimin për vjetërsi në punë në masën e 4 muaj e 15 ditë pune.

Rrëzimin e padisë lidhur me kërkimet e tjera në padi si të pabazuara në prova dhe në ligj.

5. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.3272, datë 18.12.2019 ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr. 133 (68), datë 22.02.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë në këtë mënyrë:

Detyrimin e palës së paditur Bashkia Maliq të dëmshpërblejë paditësin Aleks Nakoleci për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës me 10 (dhjetë) paga mujore.

Detyrimin e palës së paditur Bashkia Maliq të dëmshpërblejë paditësin Aleks Nakoleci për mosrespektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës me 3 (tre) paga mujore.

Detyrimin e palës së paditur Bashkia Maliq të dëmshpërblejë paditësin Aleks Nakoleci për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes kontratës së punës me 2 (dy) paga mujore.

Detyrimin e palës së paditur Bashkia Maliq të shpërblejë paditësin Aleks Nakoleci për vjetërsinë në punë me 4.5 muaj pagë.

6. Më datë **08.05.2020** Bashkia Maliq, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Ky vendim është i pabazuar në ligj dhe në prova.*
- *Në bazë të ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen administrative territoriale në Republikën e Shqipërisë” ish Komuna Vreshtas kaloi në administrim nga Bashkia Maliq dhe për këtë arsye u bë organizimi i pozicioneve të punës.*
- *Paditësi kishte lidhur një kontratë me afat të caktuar nga data 01.01.2015 deri në datë 30.09.2015 dhe me përfundimin e afatit nuk është zgjatur kontrata individuale.*
- *Kërkojmë pezullimin deri në përfundimin e gjykimit nga Gjykata e Lartë.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

7. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënie të vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto

mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

10. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

11. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes



së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Bashkia Maliq, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

15. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Bashkia Maliq, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

16. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Bashkia Maliq, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

17. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Bashkia Maliq kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

18. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Bashkia Maliq nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Bashkia Maliq.

19. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

20. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Bashkia Maliq, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.3272, datë 18.12.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “*Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

### **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.3272, datë 18.12.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit, të paraqitur nga Bashkia Maliq.

**Tiranë, më datë 22.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr.215 i Vendimit.**

**V E N D I M  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

<b>Sokol Sadushi</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Ervin Pupe</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Ilir Panda</b>	<b>Anëtar</b>

Në datën 22.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Autoriteti i Mediave Audiovizive  
Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.61 (80-2018-73), datë 19.01.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimit nr.3239 (86-2019-3660), datë 17.12.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Endirë Bushati

**PADITUR:** Autoriteti i Mediave Audiovizive  
Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Endirë Bushati, me vendimin nr.6 dhe nr.7 datë 05.11.2009 të Kuvendit të Shqipërisë është zgjedhur anëtare dhe kryetare e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (sot AMA).

2. Nga ana e palës së paditur Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendimin nr.29/204 datë 22.05.2014 është vendosur të shpallet vakant pozicioni i Kryetarit të Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe me vendimin nr.94/2014 është zgjedhur kryetari i ri.

3. Për sa më sipër, paditësja duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr.61, datë 09.01.2018 ka vendosur:

Pranimin e kërkesë padisë së paraqitur nga paditësja Endirë Bushati.

Konstatimin e paligjshëm të mbarimit të mandatit të paditëses Endirë Bushati, si kryetare e KKRT-së, të bërë nga pala e paditur Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr.94/2014 datë 06.11.2014 “Për zgjedhjen e kryetarit të Autoritetit të Mediave Audiovizive”. Detyrimin e palës së paditur Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive që t’i paguajë paditëses Endirë Bushati pagën si kryetare e KKRT-së, sot AMA, për periudhën nga momenti i ndërprerjes së mandatit datë 06.11.2014 deri në momentin e mbarimit të mandatit 21.07.2016.

5. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.3239 (86-2019-3660), datë 17.12.2019 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.61, datë 09.01.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

6. Më datë **03.06.2020** Autoritetit i Mediave Audiovizive, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Të dyja vendimet janë nxjerrë në kundërshtim të hapur me ligjin procedural dhe si pasojë e zbatimit të keq të ligjit material.*
- *Vendimi i gjykatës na ngarkon me një detyrim monetar i cili nuk mund të mbulohet nga pala e paditur, për shkakun se ekzekutimi i tij do të na sillte një dëm financiar të menjëhershëm duke sjell pasoja të rënda dhe të pariparueshme*

7. Më datë **05.06.2019** Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Me cilësinë e palës së paditur Kuvendi, duke mos qenë dakord me vendimet e të dy gjykatave, ka paraqitur rekurs dhe është argumentuar se Kuvendi nuk ka asnjë detyrim ligjor të cilin duhet ta lidhë me pretendimet financiare që kërkon paditësi.*
- *Paditësja nuk ka qenë e punësuar pranë Kuvendit, por i ka patur me Autoritetin e Mediave Audiovizive dhe në këtë logjik gjykatat kanë gabuar që kanë përfshirë Kuvendin në detyrimin për pagesën e pagës ndaj paditëses, duke e njësuar me pozitën e punëdhënësit.*
- *Referuar praktikës gjyqësore, kur Kuvendi i Shqipërisë ka vendosur shkarkimin nga detyra të drejtuesve apo anëtarëve të organeve të pavarura të krijuara me ligj, gjykatat me të drejtë nuk kanë vendosur në asnjë rast detyrimin e Kuvendit për të dëmshpërblyer financiarisht zyrtarin e shkarkuar.*

- *Vendimet e gjykatave në mënyrën se si është formuluar përmbajtja e dispozitivit e bënë atë të paekzekutueshëm, pasi ka lënë në mënyrë evazive (të papërcaktuar) masën e ekzekutimit, duke mos përcaktuar pjesën detyruese monetare të secilit prej tyre.*
- *Kjo çështje është në pritje për tu gjykuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së lartë, vendim i cili mund të ndryshojë pozitën tonë dhe ekzekutimi i këtij vendimi do të kishte pasoja të rënda financiare në buxhetin e Kuvendit të Shqipërisë.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

8. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

9. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkakimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

10. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit.”.*

11. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*

- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

12. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

13. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

14. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore pasjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

15. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

16. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

17. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, e cila ka parashtruar argumente lidhur me mos bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe në thelb të qëndrimit të saj kërkon mospranimin e kërkesës si të pabazuar në ligj.

18. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

19. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

20. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

21. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.61 (80-2018-73), datë 19.01.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimit nr.3239 (86-2019-3660), datë 17.12.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “*Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

### **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.61 (80-2018-73), datë 19.01.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimit nr.3239 (86-2019-3660), datë 17.12.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

**Tiranë, më datë 22.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr.11/264 i Vendimit.**

**V E N D I M**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi  
Ervin Pupe  
Ilir Panda**

**Kryesues  
Anëtar  
Anëtar**

Në datën 22.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Bashkia Tiranë

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.2105 (80-2015-2184), datë 04.05.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.4724 (86-2018-5340), datë 24.12.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 449, 479/a të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Shoqërisë “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k  
Shoqërisë “Albavia” sh.p.k

**PADITUR:** Bashkia Tiranë

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**



## I- RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Shoqërisë “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k dhe Shoqërisë “Albavia” sh.p.k, kanë lidhur disa kontrata me Bashkinë Tiranë për zhvillimin e punimeve të ndryshme.

2. Nga ana e palës së paditur Bashkia Tiranë nxjerrë urdhërin nr.672 datë 12.04.2011 “Për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH” dhe ka mbajtur garancinë e lënë nga paditësit, me arsyetimin se kanë shkaktuar dëm ekonomik.

3. Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr.2105 (80-2015-2184), datë 04.05.2016 ka vendosur:

- Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë.

### I.

1. Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, ti paguajë palës paditëse Shoqërisë “Karl Gega Konstruksion”, sh.p.k, dhe Shoqërisë “Albavia” sh.p.k, shumën **2.267.256 lekë**, vlerë kjo e mbajtur si garanci punimesh, si detyrim që rrjedh nga Kontrata e Prokurimit Publik Nr.Prot.7327, datë 18.09.2006 për objektin “Rikonstruksion i rrugës Niko Avrami”.

2. Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, të paguajë palës paditëse Shoqërisë “Karl Gega Konstruksion”, sh.p.k, dhe Shoqërisë “Albavia” sh.p.k, kamatat ligjore nga data 28.08.2009 ( datë e marrjes në dorëzim ) deri në ditën e aktit të ekspertimit datë 12.02.2016 në shumën **774,136 lekë**.

3. Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, ti paguajë palës paditëse Shoqërisë “Karl Gega Konstruksion”, sh.p.k, dhe Shoqërisë “Albavia” sh.p.k, kamatat ligjore llogaritur mbi vlerën e secilës fature tatimore të likuiduar me vonesë, në shumën **397.335 lekë**.

### II.

1-Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, ti paguajë palës paditëse shoqërisë “Karl Gega Konstruksion”, sh.p.k. dhe Shoqërisë “Albavia” sh.p.k. shumën e garancisë së defekteve prej **2.545.655 lekë** si detyrim që rrjedh nga Kontrata e Prokurimit publik Nr.Prot. 6844, datë 25.09.2007 për objektin “Rikonstruksion i rrugës Qemal Stafa” (Segmenti nga Rruga Barrikadave deri tek Rruga Ali Pashë Gucia).

2. Detyrimin e palës të paditur, Bashkia Tiranë, të paguajë palës paditëse shoqërisë “Karl Gega Konstruksion”, sh.p.k. dhe Shoqërisë “Albavia” sh.p.k kamatat ligjore nga data 14.12.2009 deri në ditën e aktit të ekspertimit datë 12.02.2016 në shumën **799.807 lekë**.

3.Detyrimin e palës së paditur,Bashkia Tiranë, ti paguajë palës paditëse shoqërisë “Karl Gega Konstruksion”, sh.p.k. dhe Shoqërisë “Albavia” sh.p.k. shumën e faturave të palikujduara në vlerën **356.631 lekë**.

4. Detyrimi i palës së paditur Bashkia Tiranë ti paguajë palës paditëse kamatat ligjore llogaritur mbi vlerën e secilës faturë tatimore të likuiduar me vonesë në shumën **568.612 lekë**.

### III.

1 . -Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, ti paguajë palës paditëse Shoqërisë “Albavia” sh.p.k. shumën e garancisë së defekteve prej **7.801.796 lekë** për objektin “Rikonstuksion i Infrastrukturës në Bllokun Nr.22.

2. Detyrimin e palës të paditur, Bashkia Tiranë, ti paguajë Shoqërisë “Albavia” sh.p.k kamatat ligjore të shumës së garancisë prej **7.801.796 lekë** për periudhën nga data 15.05.2013 deri në ditën e aktit të ekspertimit datë 12.02.2016 në shumën **657.175 lekë**.

3. Detyrimin e palës të paditur, Bashkia Tiranë, të paguajë Shoqërisë “Albavia” sh.p.k dëmin e shkaktuar për mospagimin e garancisë bankare në shumën **1.380.760 lekë**.
4. Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, të paguajë palës paditëse Shoqërisë “Albavia” sh.p.k. shumën për faturat e palikujduara në vlerën **5.452.191 lekë**.
5. Detyrimin e palës të paditur, Bashkia Tiranë, të paguajë Shoqërisë “Albavia” sh.p.k kamatat ligjore të faturave të palikujduara prej **5.452.191 lekë** për periudhën data 15.12.2009 deri në ditën e aktit të ekspertimit 12.02.2016 në shumën **1.717.424 lekë**.
6. Detyrimin e palës të paditur, Bashkia Tiranë, të paguajë Shoqërisë “Albavia” sh.p.k dëmin e shkaktuar prej faturave të palikujduara 5.452.191 lekë në shumën **3.112 126 lekë**.
7. Detyrimi i palës së paditur Bashkia Tiranë të paguajë Shoqërisë “Albavia” sh.p.k kamatat ligjore të llogaritura mbi vlerën e secilës faturë tatimore të likuiduar me vonesë, në shumën **6.153.106 lekë**.
8. Detyrimin e palës të paditur, Bashkia Tiranë, të paguajë Shoqërisë “Albavia” sh.p.k dëmin e shkaktuar të shlyerjes së faturave me vonesë në shumën **9.866.092 lekë**.

#### IV.

1. Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, të paguajë palës paditëse Shoqërisë “Albavia” sh.p.k. shumën e garancisë së defekteve prej **8.646.530 lekë**, për objektin “Rikonstruksioni i Infrastrukturës në Rr “Vëllezërit Kondi”.
2. Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, të paguajë palës paditëse Shoqërisë “Albavia” sh.p.k kamatat ligjore të shumës së garancisë së papaguar **8.646.530 lekë** për periudhën nga data 25.05.2007 deri në ditën e aktit të ekspertimit datë 12.02.2016 është **4.782.454 lekë**.
3. Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, të paguajë palës paditëse Shoqërisë “Albavia” sh.p.k kamatat ligjore të llogaritura mbi vlerën e secilës faturë tatimore të likuiduar me vonesë, për periudhën nga dita e 15 pas datës së lëshimit të faturës deri në ditën e aktit të ekspertimit datë 12.02.2016 në shumën **1.559.573 lekë**.
  - Rrëzimin e kërkesë padisë për pjesën tjetër si të pabazuar në ligj dhe në prova.

5. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.4724 (86-2018-5340), datë 24.12.2018 ka vendosur:  
Lënien në fuqi të vendimit nr.2105 (80-2015-2184), datë 04.05.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

6. Më datë **30.04.2019** Bashkia Tiranë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Mendojmë se vendimet janë marrë në zbatim të gabuar të ligjit material.*
- *Nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit është ushtruar kontroll pranë Bashkisë Tiranë dhe në përfundim ka konkluduar se nga paditësit, të cilët janë kontraktor për zhvillimin e punimeve të ndryshme në infrastrukturë, janë shkaktuar dëm ekonomik dhe janë përfituara të ardhura padrejtësisht.*
- *Bashkia Tiranë në vijim të rekomandimeve të KLSH ka nxjerrë urdhrin nr.672 datë 12.04.2011 “Për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH”, për mbajtjen e garancisë.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda financiare për shkak të detyrimit të lartë.*

## II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

7. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

10. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

11. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të

formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore pasjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjesisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Bashkia Tiranë, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

15. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Bashkia Tiranë, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

16. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Bashkia Tiranë, të cilët kanë parashtruar argumentet lidhur me mos bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe në thelb të qëndrimit të tyre kërkojnë mospranimin e kërkesës si të pabazuar në ligj.

17. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Bashkia Tiranë kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

18. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Bashkia Tiranë nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Bashkia Tiranë.

19. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në

shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

20. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Bashkia Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2105 (80-2015-2184), datë 04.05.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.4724 (86-2018-5340), datë 24.12.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “*Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

### **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2105 (80-2015-2184), datë 04.05.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.4724 (86-2018-5340), datë 24.12.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Bashkia Tiranë.

**Tiranë, më datë 22.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**ANËTAR**  
**Ilir Panda**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 25/294 i Vendimit.**

**V E N D I M**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi  
Ervin Pupe  
Ilir Panda**

**Kryesues  
Anëtar  
Anëtar**

Në datën 22.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Agjencia e Trajtimit të Pronave

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.30, datë 14.02.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Pavllo Çika  
Stefan Lefteri  
Eli Lefteri

**PADITUR:** Agjencia e Trajtimit të Pronave

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Pavllo Çika, Stefan Lefteri, Eli Lefteri, janë trashëgimtarët ligjor të të ndjerit Janaq Çika, të cilit me

vendimin nr. 95 datë 14.02.1996 të KKKP Vlorë, i është njohur e drejta e pronësisë mbi sipërfaqen 1410 m<sup>2</sup> dhe e drejta e kompensimit për 2490 m<sup>2</sup>.

2. Nga ana e palës së paditur Agjencia e Trajtimit të Pronave, është bërë vlerësimi financiar i pasurive të sipërcituar dhe i është njohur e drejta e kompensimit për sipërfaqen e sipërcituar në masën 14.577.630 lekë

3. Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.30, datë 14.02.2019 ka vendosur:

Pranimin e padisë së ngritur nga pala paditëse Pavllo Çika, Stefan Lefteri, Eli Lefteri si të bazuar në ligj dhe në prova.

Shfuqizimin e vlerësimit financiar të Agjencisë së Trajtimit të Pronave për vendimin nr.95 datë 14.02.1996 të KKP Bashkia Vlorë, të subjektit Janaq Çika (trashëgimtarët e tij ligjor Pavllo e Falië Çika), publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare nr. 22 datë 21.05.2018.

Detyrimin e palës së paditur të bëjë vlerësimin financiar sipas zërit kadastral të kohës së shpronësimit “truall”.

5. Më datë **20.05.2019** Agjencia e Trajtimit të Pronave, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtrohet sa vijon:

- *Ligji nr.133/2015 ka përcaktuar se kur është ushtruar rekurs vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit bëhet përfundimtar dhe i ekzekutueshëm sipas ligjit kur ka përfunduar shqyrtimi i rekursit në Gjykatë të Lartë .*
- *Ligji nr.133/2015 ka qenë objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese, e cila nuk ka konstatuar konflikte midis normave dhe ligji i posaçëm ka epërsi ndaj rregullave të përgjithshme.*
- *ATP ka kryer vlerësimin financiar sipa metodologjisë së vlerësimeve të vendimeve të ish KKKP, në referim të nenit 7 pika 2/a.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda për palën e paditur.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të ezullu në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të

ekzistojë një rrezik i ezulluese dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të ezulluese të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat ezulluese të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar



nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Agjencia e Trajtimit të Pronave, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

14. Duke iu rikthyer rastit konkret, kërkuesi, ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, e cila ka ushtruar juridiksion fillestar dhe ka disponuar mbi një vendim të Agjencisë së Trajtimit të Pronës, bazuar në Ligjin nr. 133/2015 “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave” (në vijim Ligji nr. 133/2015).

15. Kolegji vlerëson se Ligji nr. 133/2015 është me natyrë mikse, sepse përmban norma juridike të karakterit material dhe procedural. Dispozitat materiale përcaktojnë rregullat dhe kriteret mbi bazën e të cilave organi administrativ kompetent (konkretisht ATP), e më tej gjykata do të vendosë mbi kërkesat e ish-pronarëve për njohje dhe kompensim të pronës. Nga ana tjetër, dispozitat procedurale disiplinojnë në mënyrë të posaçme (lex specialis), veprimtarinë e organit administrativ përgjegjës për trajtimin e kërkesave të ish-pronarëve për kompensim të pronës, afatet e veprimit administrativ, të drejtën ankimit dhe afatet e ankimit të subjekteve të procedimit administrativ, për të kundërshtuar vendimet e ATP-së në gjykatë, kompetencën e gjykatave që do të shqyrtojnë këto mosmarrëveshje etj. Në mënyrë të posaçme, ky ligj i ka njohur juridiksion fillestar gjykatave të apelit dhe Gjykatës Administrative të Apelit, sipas neneve 19 dhe 29, kur objekt kontrolli kanë qënë vendime të ATP-së, vendime të ish-KKKP-ve, ish-ZRVKKP-ve apo ish-AKKP-së, që kanë disponuar në lidhje me kërkesën e ish-pronarëve, për njohjen, kthimin apo kompensimin e pronës. (Vendim Njësues nr. 611, datë 07.02.2018 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).

16. Në vijim të këtij arsytimi, Kolegji sjell në vëmendje nenin 5/17 të Ligjit nr. 133/2015, nën titullin “**Përkufizime**”, ku është parashikuar se: “...Vendim “përfundimtar” është çdo vendim administrativ ose gjyqësor, i cili nuk i nënshtrohet më një procedure kontrolli dhe rishikimi nga një autoritet më i lartë administrativ ose gjyqësor, duke përfshirë këtu vendimet e formës së prerë dhe kur këto i janë nënshtruar rekursit, si përfundimtar konsiderohet vendimi i Gjykatës së Lartë...” Kjo dispozitë me natyrë procedurale përcakton se kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë dhe bëhet i ekzekutueshëm për qëllime të këtij ligji, në rastin kur mosmarrëveshja midis ish-pronarit dhe shtetit i nënshtrohet juridiksionit gjyqësor. Nga ana tjetër, Kolegji thekson se, kjo dispozitë, për situatën kur gjykata e apelit ka ushtruar juridiksion fillestar, është në harmoni edhe me parashikimin e përgjithshëm të nenit 451 të K.Pr.Civile (lex generalis), sipas të cilit vendimi i gjykatës merr formë të prerë, ndër të tjera, kur është vendosur lënia në fuqi, ndryshimi i vendimit apo është vendosur pushimi i gjykimit në shkallë të dytë (pika ç). Sipas kësaj dispozite vendimi i gjykatës merr formë të prerë pas një procesi gjyqësor dy shkallësh, si rrjedhojë vendimi i gjykatës së apelit civil apo administrativ, në rastet kur gjykata e apelit ushtron juridiksion fillestar, (apo e thënë ndryshe ka gjykuar si shkallë e parë) dhe ndaj vendimit është ushtruar rekurs, nuk mund të konsiderohet si vendim gjyqësor i formës së prerë. Rekursi në këtë rast ka sjellë efektet juridike të parandalimit të marrjes formë të prerë. Si rrjedhojë, vendimi i gjykatës së apelit do të marrë formë të prerë pasi të përfundojë shqyrtimi i rekursit në Gjykatën e Lartë, si shkalla e dytë e gjykimit.

17. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, në rastin konkret, kërkesa e kërkuarit është pa objekt sepse paraqitja e rekursit ka ez iure efekte ezulluese për vendimin e dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit. Ky i fundit në rastin konkret nuk është i formës së prerë dhe sikurse u arsyetua më sipër neni 479 i K.Pr.Civile fushën e zbatimit e ka vetëm për vendimet objekt rekursi të gjykatës së apelit me juridiksion rishikues.

18. Kolegji vlerëson të rëndësishme të theksojë se nuk ka patur një praktikë të qartë në lidhje me interpretimin e Ligjit nr. 133/2015, në raport me nenin 451 të K.Pr.Civile, në raste të tilla, në lidhje me çështjen nëse janë apo jo të formës së prerë vendimet e gjykatave të apelit me juridiksion fillestar. Kolegji vlerëson se qëndrimi i mbajtur në rastin konkret, sipas të cilit vendimet e gjykatave civile të apelit apo të Gjykatës Administrative të Apelit me juridiksion fillestar sipas Ligjit nr. 133/2015, do të jetë i zbatueshëm edhe për rastet e ngjashme në të ardhmen (pro futuro). Si rrjedhojë Kolegji thekson se çdo kërkesë e palëve në të ardhmen për pezullimin e ekzekutimit të vendimit sipas nenit 479 të K.Pr.Civile në raste të tilla do të vlerësohet në kuptim të kërkesave të parashikuar në nenin 34 të K.Pr.Civile të ndryshuar.

19. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuare Agjencia e Trajtimit të Pronave, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.30, datë 14.02.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

## **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “*Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

## **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.30, datë 14.02.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Agjencia e Trajtimit të Pronave.

**Tiranë, më datë 22.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**ANËTAR**  
**Illir PANDA**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr.32/305 i Vendimit.**

**V E N D I M  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi  
Ervin Pupe  
Ilir Panda**

**Kryesues  
Anëtar  
Anëtar**

Në datën 22.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Ministria e Mbrojtjes

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.2944, datë 01.06.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me vendimin nr.4305, datë 26.11.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Uran Deliu etj

**PADITUR:** Ministria e Mbrojtjes  
Ndërmarrja “MEICO”  
Shoqëria “Albademil” sh.p.k

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1- Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Uran Deliu etj, janë trashëgimtar të të ndjerëve Qemal Deliu dhe Kore Deliu, të cilën kanë humbur jetën në aksidentin e ndodhur në Gërdec.

2- Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

**3- Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr.2944, datë 01.06.2015 ka vendosur:

Pranimin e pjesëshëm të padisë.

Detyrimin e palëve të paditur Ministria e Mbrojtjes, Ndërmarrja “MEICO”, Shoqëria “Albademil” sh.p.k, që solidarisht t’i paguajën paditësive:

Dëmshpërblim për dëmin pasuror dhe jo pasuror (moral, ekzistencial), për humbjen e jetës së të ndjerit Qemal Deliu, në vlerën 27.148.048 lekë (sipas aktit të ekspertimit).

Dëmshpërblim për dëmin pasuror dhe jo pasuror (moral, ekzistencial), për humbjen e jetës së të ndjerit Korre Deliu, në vlerën 26.895.950 lekë (sipas aktit të ekspertimit).

Dëmshpërblim për dëmin pasuror dhe jo pasuror (moral, ekzistencial), për humbjen e jetës së të ndjerit Jetmir Deliu, në vlerën 35.158.582 lekë (sipas aktit të ekspertimit).

Dëmshpërblim për dëmin pasuror dhe jo pasuror (moral, ekzistencial), për humbjen e jetës së të ndjerit Flavio Deliu, në vlerën 35.984.073 lekë (sipas aktit të ekspertimit).

Dëmshpërblim për dëmin pasuror dhe jo pasuror (moral, ekzistencial), për humbjen e jetës së të ndjerit Liljana Deliu, në vlerën 33.634.049 lekë (sipas aktit të ekspertimit).

Rrëzimin e padisë për palën e paditur Këshilli i Ministrave, për mungesë legjitimitimit pasiv.

**4- Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.4305, datë 26.11.2018 ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr.2944, datë 01.06.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Pranimin e pjesëshëm të padisë.

Detyrimin e palëve të paditur Ministria e Mbrojtjes, Ndërmarrja “MEICO”, Shoqëria “Albademil” sh.p.k, që solidarisht t’i paguajën paditësit Uran Deliu, shumën 33.663.165 lekë, si dëmshpërblim për dëmin pasuror dhe jo pasuror që i është shkaktuar si pasojë e vdekjes së babit, nënës, vëllait, fëmijës dhe bashkëshortes.

Detyrimin e palëve të paditur Ministria e Mbrojtjes, Ndërmarrja “MEICO”, Shoqëria “Albademil” sh.p.k, që solidarisht t’i paguajën paditësit Ilirjan Deliu, shumën 20.438.167 lekë, si dëmshpërblim për dëmin pasuror dhe jo pasuror që i është shkaktuar si pasojë e vdekjes së babit, nënës, vëllait dhe nipit.

Detyrimin e palëve të paditur Ministria e Mbrojtjes, Ndërmarrja “MEICO”, Shoqëria “Albademil” sh.p.k, që solidarisht t’i paguajën paditësit Gentjan Deliu, shumën 20.438.167 lekë, si dëmshpërblim për dëmin pasuror dhe jo pasuror që i është shkaktuar si pasojë e vdekjes së babit, nënës, vëllait dhe nipit.

Detyrimin e palëve të paditur Ministria e Mbrojtjes, Ndërmarrja “MEICO”, Shoqëria “Albademil” sh.p.k, që solidarisht t’i paguajën paditëses Irena Deliu, shumën 20.438.167 lekë, si dëmshpërblim për dëmin pasuror dhe jo pasuror që i është shkaktuar si pasojë e vdekjes së babit, nënës, vëllait dhe nipit.

Detyrimin e palëve të paditur Ministria e Mbrojtjes, Ndërmarrja “MEICO”, Shoqëria “Albademil” sh.p.k, që solidarisht t’i paguajën paditësit Fuada Kënga (Deliu), shumën 20.438.167 lekë, si dëmshpërblim për dëmin pasuror dhe jo pasuror që i është shkaktuar si pasojë e vdekjes së babit, nënës, vëllait dhe nipit.

Rrëzimin e padisë për palën e paditur Këshilli i Ministrave dhe për pjesën tjetër të kërtimeve.

5- Më datë **23.05.2019** Ministria e Mbrojtjes, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- Gjykata Administrative e Apelit nuk ka zhvilluar një hetim të plotë dhe të gjithanshëm dhe nuk janë vlerësuar provat përkatëse në kundërshtim me nenet 10, 11, 14, 16, 20/2, 28, 29 të K.Pr.Civile.
- Një fakt shumë i rëndësishëm në kuptim të ligjit procedural ka të bëjë me krijimin e ndërgjyqësisë si dhe mungesën e legjitimitetit pasiv të Ministrisë së Mbrojtjes dhe duhej të thirrej shoqëria Amerikane “SAC Inc” e cila së bashku me shoqërinë “Albademil” shpk kanë kryer aktivitetin e demontimit në Gërdec.
- Nga ana e gjykatës nuk është sqaruar plotësisht marrëdhënia juridike, pasi viktimat kanë qenë të punësuar pranë të paditurit shoqërinë “Albademil” shpk dhe për këtë ka ekzistuar marrëdhënia juridike e punës, prandaj nuk mund të kemi dy kërkime të ndryshme edhe shpërblim dëmi jashtëkontraktor dhe shpërblim dëmi që rrjedh nga një marrëdhënie kontraktore.
- Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda ekonomike, pasi është një vlerë e konsiderueshme.

## II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

6- Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7- Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8- Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit.”.

9- Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të

vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

10- Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11- Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12- Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore pasjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Ministria e Mbrojtjes, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

14- Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Ministria e Mbrojtjes, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

15- Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Ministria e Mbrojtjes, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

16- Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Ministria e Mbrojtjes kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e

shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

17- Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Ministria e Mbrojtjes nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Ministria e Mbrojtjes.

18- Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

19- Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Ministria e Mbrojtjes, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2944, datë 01.06.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me vendimin nr.4305, datë 26.11.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

## **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

## **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2944, datë 01.06.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me vendimin nr.4305, datë 26.11.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Ministria e Mbrojtjes.

**Tiranë, më datë 22.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 37/312 i Vendimit.**

**V E N D I M**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi  
Ervin Pupe  
Ilir Panda**

**Kryesues  
Anëtar  
Anëtar**

Në datën 22.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.3539, datë 06.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe vendimit nr.4131, datë 16.11.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Edmond Vila

**PADITUR:** Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Edmond Vila, ka qenë ushtarak prej 1981 dhe pas daljes në rezervë ka paraqitur pranë palës së paditur DRSSH Tiranë kërkesën për pension të parakohshëm për vjetërsi në shërbim.



2. Nga ana e palës së paditur DRSSH Tiranë me vendimin nr.4988 datë 11.12.2008, i është caktuar paditësi pension i parakohshëm për vjetërsi në shërbim në masën 1903 lekë/muaj.

3. Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe pasi ka shteruar ankimin administrativ, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr.3539, datë 06.07.2016 ka vendosur:

Pranimin e kërkesë padisë së paditësit Edmond Vila.

Detyrimin e palës së paditur Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, t'i rillogarisë dhe paguajë paditësit Edmond Vila diferencat e papaguara të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, llogaritur sipas parashikimeve ligjit nr. 9210, datë 23. 03. 2004, 'Për Statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë', nga nga data 01.09.2008 deri me datë 01.07.2009, në konsiderim edhe të VKM-ve respektive për rritjen e pensionit të parakohshëm, detyrim i cili, është në masën 191339 lekë (llogaritur si diferencë midis masës së pensionit për vjetërsi shërbimi të rillogaritur, në raport me atë të dhënë nga DRSSH Tiranë).

5. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.4131, datë 16.11.2018 ka vendosur:

Mospranimin e ankimit të palës së paditur Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë kundër vendimit nr.3539, datë 06.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

6. Më datë **30.05.2019** Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Pas përfundimit të procesit gjyqësor në Gjykatën e Apelit Administrativ nga ana e DRSSH Tiranë është ushtruar rekurs me shkresën nr.4741 prot., datë 11.12.2018.*
- *Ky vendim nuk mund të vihet në zbatim nga ana e DRSSH pasi duke filluar nga hyrja në fuqi e vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë nr.3 datë 24.11.2016, është në kundërshtim me këtë vendim.*
- *Gjykata Administrative e Apelit pasi u vu në dijeni të këtij vendim nuk e mori parasysh, pasi llogaritja e përfitimeve ka ndryshuar totalisht duke u kufizuar në masën totale në mbështetje të ligjit nr.8087/1996 i ndryshuar.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda ekonomike dhe një precedent të rrezikshëm.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

7. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm,

sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkakimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

10. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

11. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese

duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

15. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

16. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

17. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

18. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

19. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar

njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

20. Gjithashtu ky Kolegji vlerëson të theksojë se marrja e masës së pezullimi të një vendim të formës së prerë është e lidhur ngushtësisht me zbatimin e dispozitave konkrete mbi ankimin apo rekursin, konkretisht neni 45 dhe neni 56 të ligjit procedural nr.49/2012 “*Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*”, respektimi i të cilit është detyrim për çdo gjykatë apo palë ndërgjyqëse. Kushtet e parashikuar nga ligji procedural mbi të drejtën për të ushtruar rekurs dhe kufizimet e parashikuara prej tij, janë të detyrueshme për zbatim, pasi nga respektimi i tyre varet dhe zgjidhja e çështjeve objekt shqyrtimi.

21. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.3539, datë 06.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe vendimit nr.4131, datë 16.11.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “*Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

### **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.3539, datë 06.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe vendimit nr.4131, datë 16.11.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

**Tiranë, më datë 22.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr.40/317 i Vendimit.**

**V E N D I M**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi  
Ervin Pupe  
Irir Panda**

**Kryesues  
Anëtar  
Anëtar**

Në datën 22.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Avokatura e Shtetit

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.45, datë 01.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Minerva Kotherja etj

**PADITUR:** Agjencia e Trajtimit të Pronave

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Minerva Kotherja, është një nga trashgimtarët ligjor të të ndjerit Kamber Gjergji (trashgimtarët e Shefikat Bylykbashi), të cilët me vendimin nr.10/1 datë 29.10.1998 të ish KKKP Elbasan i

është njohur dhe kompensuar sipërfaqja prej 32.000 m<sup>2</sup>, në parcelën nr.kadastral 383,40 dhe është bërë kompensimi për sipërfaqen 32.000 m<sup>2</sup> x 17.1 lekë/m<sup>2</sup> në shumën 547.200 lekë.

2. Nga ana e palës së paditur Agjencia e Trajtimit të Pronave, është bërë vlerësimi financiar i pasurisë së sipërcituar sipas Buletinit të Njoftimeve Zyrtare nr.21 datë 14.05.2018.

3. Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.45, datë 01.03.2019 ka vendosur:

Pranimin pjesërisht të padisë.

Shfuqizimin pjesërisht të vlerësimit financiar të bërë nga pala e paditur, Agjencia e Trajtimit të Pronave, ndaj vendimit nr.10/1 datë 29.10.1998 të ish KKK Pronave të ish pronarëve pranë Këshillit të Rrethit Elbasan.

Detyrimin e palës së paditur të kompensojë financiarisht trashëgimtarët e ish pronarit Kamber Gjergji edhe për vlerën e interesit bankar mbi shumën 547 200 lekë, nga data 29.10.1998, deri në marrjen e shpërblimit.

Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të saj.

5. Më datë **05.06.2019** Avokatura e Shtetit, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është marrë në interpretim të gabuar të ligjit nr.133/2015 dhe në shkelje të rënda të normave procedurale.*
- *Duke i'u referuar kërkesë padisë objekt gjykimi është kontradiktor dhe i pabazuar në nenin 19 të ligjit nr.133/2015, pasi kjo padi është e parashkruar.*
- *Vlerësimi i pronës është bërë mbi parashikimet e ligjit nr.133/2015, i cili pranohet edhe nga gjykata por ajo tejkalon parashikimet kur thekson se paditësi legjitimohet të kundërshtojë vlerën financiare dhe jo metodologjinë.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda dhe do të njihet paditësit një vlerësim të pabazuar.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të

ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore pasjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar

nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjesisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Avokatura e Shtetit, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

14. Duke iu rikthyer rastit konkret, kërkuesi, ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, e cila ka ushtruar juridiksion fillestar dhe ka disponuar mbi një vendim të Agjencisë së Trajtimit të Pronës, bazuar në Ligjin nr. 133/2015 “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave” (në vijim Ligji nr. 133/2015).

15. Kolegji vlerëson se Ligji nr. 133/2015 është me natyrë mikse, sepse përmban norma juridike të karakterit material dhe procedural. Dispozitat materiale përcaktojnë rregullat dhe kriteret mbi bazën e të cilave organi administrativ kompetent (konkretisht ATP), e më tej gjykata do të vendosë mbi kërkesat e ish-pronarëve për njohje dhe kompensim të pronës. Nga ana tjetër, dispozitat procedurale dispijlojnë në mënyrë të posaçme (lex specialis), veprimtarinë e organit administrativ përgjegjës për trajtimin e kërkesave të ish-pronarëve për kompensim të pronës, afatet e veprimit administrativ, të drejtën ankimit dhe afatet e ankimit të subjekteve të procedimit administrativ, për të kundërshtuar vendimet e ATP-së në gjykatë, kompetencën e gjykatave që do të shqyrtojnë këto mosmarrëveshje etj. Në mënyrë të posaçme, ky ligj i ka njohur juridiksion fillestar gjykatave të apelit dhe Gjykatës Administrative të Apelit, sipas neneve 19 dhe 29, kur objekt kontrolli kanë qënë vendime të ATP-së, vendime të ish-KKKP-ve, ish-ZRVKKP-ve apo ish-AKKP-së, që kanë disponuar në lidhje me kërkesën e ish-pronarëve, për njohjen, kthimin apo kompensimin e pronës. (Vendim Njësues nr. 611, datë 07.02.2018 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).

16. Në vijim të këtij arsytimi, Kolegji sjell në vëmendje nenin 5/17 të Ligjit nr. 133/2015, nën titullin “**Përkufizime**”, ku është parashikuar se: “...Vendim “përfundimtar” është çdo vendim administrativ ose gjyqësor, i cili nuk i nënshtrohet më një procedure kontrolli dhe rishikimi nga një autoritet më i lartë administrativ ose gjyqësor, duke përfshirë këtu vendimet e formës së prerë dhe kur këto i janë nënshtrohet rekursit, si përfundimtar konsiderohet vendimi i Gjykatës së Lartë...” Kjo dispozitë me natyrë procedurale përcakton se kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë dhe bëhet i ekzekutueshëm për qëllime të këtij ligji, në rastin kur mosmarrëveshja midis ish-pronarit dhe shtetit i nënshtrohet juridiksionit gjyqësor. Nga ana tjetër, Kolegji thekson se, kjo dispozitë, për situatën kur gjykata e apelit ka ushtruar juridiksion fillestar, është në harmoni edhe me parashikimin e përgjithshëm të nenit 451 të K.Pr.Civile (lex generalis), sipas të cilit vendimi i gjykatës merr formë të prerë, ndër të tjera, kur është vendosur lënia në fuqi, ndryshimi i vendimit apo është vendosur pushimi i gjykimit në shkallë të dytë (pika ç). Sipas kësaj dispozite vendimi i gjykatës merr formë të prerë pas një procesi gjyqësor dy shkallësh, si rrjedhojë vendimi i gjykatës së apelit civil apo administrativ, në rastet kur gjykata e apelit ushtron juridiksion fillestar, (apo e thënë ndryshe ka gjykuar si shkallë e parë) dhe ndaj vendimit është ushtruar rekurs, nuk mund të konsiderohet si vendim gjyqësor i formës së prerë. Rekursi në këtë rast ka sjellë efektet juridike të parandalimit të marrjes formë të prerë. Si rrjedhojë, vendimi i gjykatës së apelit do të marrë formë të prerë pasi të përfundojë shqyrtimi i rekursit në Gjykatën e Lartë, si shkalla e dytë e gjykimit.



17. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, në rastin konkret, kërkesa e kërkuarit është pa objekt sepse paraqitja e rekursit ka ipso iure efekte pezulluese për vendimin e dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit. Ky i fundit në rastin konkret nuk është i formës së prerë dhe sikurse u arsyetua më sipër nën 479 i K.Pr.Civile fushën e zbatimit e ka vetëm për vendimet objekt rekursi të gjykatës së apelit me juridiksion rishikues.

18. Kolegji vlerëson të rëndësishme të theksojë se nuk ka patur një praktikë të qartë në lidhje me interpretimin e Ligjit nr. 133/2015, në raport me nenin 451 të K.Pr.Civile, në raste të tilla, në lidhje me çështjen nëse janë apo jo të formës së prerë vendimet e gjykatave të apelit me juridiksion fillestar. Kolegji vlerëson se qëndrimi i mbajtur në rastin konkret, sipas të cilit vendimet e gjykatave civile të apelit apo të Gjykatës Administrative të Apelit me juridiksion fillestar sipas Ligjit nr. 133/2015, do të jetë i zbatueshëm edhe për rastet e ngjashme në të ardhmen (pro futuro). Si rrjedhojë Kolegji thekson se çdo kërkesë e palëve në të ardhmen për pezullimin e ekzekutimit të vendimit sipas nenit 479 të K.Pr.Civile në raste të tilla do të vlerësohet në kuptim të kërkesave të parashikuar në nenin 34 të K.Pr.Civile të ndryshuar.

19. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuar Avokatura e Shtetit, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.45, datë 01.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

## **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile

## **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.45, datë 01.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Avokatura e Shtetit.

**Tiranë, më datë 22.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 41/318 i Vendimit.**

**V E N D I M  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

<b>Sokol Sadushi</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Ervin Pupe</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Ilir Panda</b>	<b>Anëtar</b>

Në datën 22.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Avokatura e Shtetit

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.56, datë 13.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Ilirjan Cani

**PADITUR:** Agjencia e Trajtimit të Pronave

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Ilirjan Cani, është një nga trashëgimtarët ligjor të të ndjerit Sulejman e Ibrahim Hasa (Cani), të cilët me vendimin nr.405 datë 29.09.1995 të ish KKKP Tiranë i është njohur dhe kompensuar një sipërfaqe si ish pronar.

2. Nga ana e palës së paditur Agjencia e Trajtimit të Pronave, është bërë vlerësimi financiar i pasurisë së sipërcituar sipas Buletinit të Njoftimeve Zyrtare dhe nga ana e paditësit duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

3. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.56, datë 13.03.2019 ka vendosur:

Pranimin e pjesshëm të padisë së paditësit Ilirjan Cani.

Ndryshimin e vlerësimit të kompensimit financiar të bërë nga pala e paditur Agjencia e Trajtimit të Pronave për vendimin nr.405 datë 29.09.1995 të ish KKK Pronave Tiranë duke bërë rivlerësimin financiar për sipërfaqen e njohur për kompensimin prej 7734 m2 nga zëri kadastral “arë” në zë kadastral “truall”, sipas çmimit të hartës së vlerës të publikuar në VKM nr.89 datë 03.02.2016, për llojin tokës truall duke i’u referuar çmimit të zonës kadastrale ku ndodhet prona.

Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të saj.

4. Më datë **05.06.2019** Avokatura e Shtetit, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Vendimi i gjykatës është marrë në kundërshtim me ligjin material, është interpretuar dhe zbatuar keq, që cënon njësimin e praktikës gjyqësore.*
- *Gjykata nuk ka arsyetuar me argumenta ligjor se përse procedura ligjore e ndjekur nga ATP, nuk është i drejtë dhe me mbështetje ligjore, pasi ATP në përfundim ka vendosur se subjektit të shpronësuar Sulejman e Ibrahim Hasa (Cani) është vlerësuar financiarisht për sipërfaqen 7734 m2, me çmimin 448 lekë/m2, sipas dokumentacionit të ndodhur në dosje dhe ligjit nr.133/2015.*
- *Gjykata Administrative e Apelit po ndjke një metodologji ndryshe nga ligji i pronave, duke cënuar kështu njësimin e praktikës gjyqësore, pasi vlerësimi është bërë në përputhje me nenin 6 të ligjit nr.133/2015, i cili i është nënshtruar edhe gjykimit nga Gjykata Kushtetuese, e cila e ka lënë në fuqi.*
- *Akti i ekspertimit ka përcaktuar se kjo pronë në vitin 1945-1955 ka qenë brenda vijave kufizuese të qytetit të Tiranës, por ATP në momentin e shpronësimit në vitin 1959 kjo pronë ka qenë në zërin kadastral tokë bujqësore dhe në bazë të këtij kriteri është bërë vlerësimi i pronës.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda dhe të pariparueshme.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

5. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

6. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

7. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

8. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

9. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

10. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të

formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

11. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

12. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Avokatura e Shtetit, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

13. Duke iu rikthyer rastit konkret, kërkuesi, ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, e cila ka ushtruar juridiksion fillestar dhe ka disponuar mbi një vendim të Agjencisë së Trajtimit të Pronës, bazuar në Ligjin nr. 133/2015 “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave” (në vijim Ligji nr. 133/2015).

14. Kolegji vlerëson se Ligji nr. 133/2015 është me natyrë mikse, sepse përmban norma juridike të karakterit material dhe procedural. Dispozitat materiale përcaktojnë rregullat dhe kriteret mbi bazën e të cilave organi administrativ kompetent (konkretisht ATP), e më tej gjykata do të vendosë mbi kërkesat e ish-pronarëve për njohje dhe kompensim të pronës. Nga ana tjetër, dispozitat procedurale disiplinojnë në mënyrë të posaçme (lex specialis), veprimtarinë e organit administrativ përgjegjës për trajtimin e kërkesave të ish-pronarëve për kompensim të pronës, afatet e veprimit administrativ, të drejtën ankimit dhe afatet e ankimit të subjekteve të procedimit administrativ, për të kundërshtuar vendimet e ATP-së në gjykatë, kompetencën e gjykatave që do të shqyrtojnë këto mosmarrëveshje etj. Në mënyrë të posaçme, ky ligj i ka njohur juridiksion fillestar gjykatave të apelit dhe Gjykatës Administrative të Apelit, sipas neneve 19 dhe 29, kur objekt kontrolli kanë qenë vendime të ATP-së, vendime të ish-KKKP-ve, ish-ZRVKKP-ve apo ish-AKKP-së, që kanë disponuar në lidhje me kërkesën e ish-pronarëve, për njohjen, kthimin apo kompensimin e pronës. (Vendim Njësues nr. 611, datë 07.02.2018 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).

15. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji sjell në vëmendje nenin 5/17 të Ligjit nr. 133/2015, nën titullin “**Përkufizime**”, ku është parashikuar se: “...Vendim “përfundimtar” është çdo vendim administrativ ose gjyqësor, i cili nuk i nënshtrohet më një procedure kontrolli dhe rishikimi nga një autoritet më i lartë administrativ ose gjyqësor, duke përfshirë këtu vendimet e formës së prerë dhe kur këto i janë nënshtruar rekursit, si përfundimtar konsiderohet vendimi i Gjykatës së Lartë...” Kjo dispozitë me natyrë procedurale përcakton se kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë dhe bëhet i ekzekutueshëm për qëllime të këtij ligji, në rastin kur mosmarrëveshja midis ish-pronarit dhe shtetit i nënshtrohet juridiksionit gjyqësor. Nga ana tjetër, Kolegji thekson se, kjo dispozitë, për situatën kur gjykata e apelit ka ushtruar juridiksion fillestar, është në harmoni edhe me parashikimin e përgjithshëm të nenit 451 të K.Pr.Civile (lex generalis), sipas të cilit vendimi i gjykatës merr formë të prerë, ndër të tjera, kur është vendosur lënia në fuqi, ndryshimi i vendimit apo është vendosur pushimi i gjykimit në shkallë të dytë (pika ç). Sipas kësaj dispozite vendimi i gjykatës merr formë të prerë pas një procesi gjyqësor dy shkallësh, si rrjedhojë vendimi i gjykatës së apelit civil apo administrativ, në rastet kur gjykata e apelit ushtron juridiksion fillestar, (apo e thënë ndryshe ka gjykuar si shkallë e parë) dhe ndaj vendimit është ushtruar rekurs, nuk mund të

konsiderohet si vendim gjyqësor i formës së prerë. Rekursi në këtë rast ka sjellë efektet juridike të parandalimit të marrjes formë të prerë. Si rrjedhojë, vendimi i gjykatës së apelit do të marrë formë të prerë pasi të përfundojë shqyrtimi i rekursit në Gjykatën e Lartë, si shkalla e dytë e gjykimit.

16. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, në rastin konkret, kërkesa e kërkuarit është pa objekt sepse paraqitja e rekursit ka ipso iure efekte pezulluese për vendimin e dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit. Ky i fundit në rastin konkret nuk është i formës së prerë dhe sikurse u arsyetua më sipër nën 479 i K.Pr.Civile fushën e zbatimit e ka vetëm për vendimet objekt rekursi të gjykatës së apelit me juridiksion rishikues.

17. Kolegji vlerëson të rëndësishme të theksojë se nuk ka patur një praktikë të qartë në lidhje me interpretimin e Ligjit nr. 133/2015, në raport me nenin 451 të K.Pr.Civile, në raste të tilla, në lidhje me çështjen nëse janë apo jo të formës së prerë vendimet e gjykatave të apelit me juridiksion fillestar. Kolegji vlerëson se qëndrimi i mbajtur në rastin konkret, sipas të cilit vendimet e gjykatave civile të apelit apo të Gjykatës Administrative të Apelit me juridiksion fillestar sipas Ligjit nr. 133/2015, do të jetë i zbatueshëm edhe për rastet e ngjashme në të ardhmen (pro futuro). Si rrjedhojë Kolegji thekson se çdo kërkesë e palëve në të ardhmen për pezullimin e ekzekutimit të vendimit sipas nenit 479 të K.Pr.Civile në raste të tilla do të vlerësohet në kuptim të kërkesave të parashikuar në nenin 34 të K.Pr.Civile të ndryshuar.

18. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuuese Avokatura e Shtetit, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.56, datë 13.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

## **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile

## **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.56, datë 13.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Avokatura e Shtetit.

**Tiranë, më datë 22.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr.73/386 i Vendimit.**

**V E N D I M  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi  
Ervin Pupe  
Ilir Panda**

**Kryesues  
Anëtar  
Anëtar**

Në datën 22.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Agjencia e Trajtimit të Pronave

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.104 (86-2019-1447), datë 25.04.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Përparime Shehu

**PADITUR:** Agjencia e Trajtimit të Pronave

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1- Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Përparime Shehu, është një nga trashëgimtarët ligjor të ndjerit Mynyvere Shehu, i cili është një nga subjektet e shpronësuara njohur me vendimin nr.526 datë 27.12.1995 nga KKKP Bashkia Tepelenë.

2- Nga ana e palës së paditur Agjencia e Trajtimit të Pronave, është bërë vlerësimi financiar i pasurive të sipërcituar dhe i është njohur e drejta e kompensimit në vlerën – 2.052.368 lekë.

3- Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.104 (86-2019-1447), datë 25.04.2019 ka vendosur:

Pranimin e padisë së paditëses Përparime Shehu.

Shfuqizimin e vlerësimit financiar të kryer nga pala e paditur Agjencia e Trajtimit të Pronave përmbajtur në shkresën nr.5116/1 prot., datë 06.08.2018, për vendimin nr.70 datë 27.12.1995 të ish-Komisionit të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave Tepelenë, i ndryshuar, duke detyruar palën e paditur të bëjë vlerësimin financiar të këtij vendimi përputhje me parashikimet e ligjit.

5. Më datë **31.07.2019** Agjencia e Trajtimit të Pronave, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtrohet sa vijon:

- *Vendimi i dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit është marrë në shkelje të ligjit procedural dhe atij material.*
- *Gjykata duhet të kishte dalë me mospranim padie, pasi paditësi i është drejtuar gjykatës jashtë afatit ligjor të parashikuar në nenin 19 të ligjit nr.133/2015.*
- *Vendimi i Gjykatës Administrative e Apelit është i pamundur të ekzekutohet, pasi ATP nuk e ka më as kompetencë funksionale.*
- *Në analizë të gjitha rrethanave dhe fakteve, vlerësimet e gjykatës janë të pabazuara dhe në interpretim të gabuar të provave gjyqësore dhe për rrjedhojë në kundërshtim me ligjin nr.133/2015 dhe për rrjedhojë kërkojmë pezullimin ekzekutimit deri në shqyrtimin e rekursit nga Gjykata e Lartë.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.



8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e

paraqitur nga pala e paditur, Agjencia e Trajtimit të Pronave, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

14- Duke iu rikthyer rastit konkret, kërkuesi, ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, e cila ka ushtruar juridiksion fillestar dhe ka disponuar mbi një vendim të Agjencisë së Trajtimit të Pronës, bazuar në Ligjin nr. 133/2015 “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave” (në vijim Ligji nr. 133/2015).

15. Kolegji vlerëson se Ligji nr. 133/2015 është me natyrë mikse, sepse përmban norma juridike të karakterit material dhe procedural. Dispozitat materiale përcaktojnë rregullat dhe kriteret mbi bazën e të cilave organi administrativ kompetent (konkretisht ATP), e më tej gjykata do të vendosë mbi kërkesat e ish-pronarëve për njohje dhe kompensim të pronës. Nga ana tjetër, dispozitat procedurale disiplinon në mënyrë të posaçme (lex specialis), veprimtarinë e organit administrativ përgjegjës për trajtimin e kërkesave të ish-pronarëve për kompensim të pronës, afatet e veprimit administrativ, të drejtën ankimit dhe afatet e ankimit të subjekteve të procedimit administrativ, për të kundërshtuar vendimet e ATP-së në gjykatë, kompetencën e gjykatave që do të shqyrtojnë këto mosmarrëveshje etj. Në mënyrë të posaçme, ky ligj i ka njohur juridiksion fillestar gjykatave të apelit dhe Gjykatës Administrative të Apelit, sipas neneve 19 dhe 29, kur objekt kontrolli kanë qënë vendime të ATP-së, vendime të ish-KKKP-ve, ish-ZRVKKP-ve apo ish-AKKP-së, që kanë disponuar në lidhje me kërkesën e ish-pronarëve, për njohjen, kthimin apo kompensimin e pronës. (Vendim Njësues nr. 611, datë 07.02.2018 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).

16. Në vijim të këtij arsytimi, Kolegji sjell në vëmendje nenin 5/17 të Ligjit nr. 133/2015, nën titullin “**Përkufizime**”, ku është parashikuar se: “...Vendim “përfundimtar” është çdo vendim administrativ ose gjyqësor, i cili nuk i nënshtrohet më një procedure kontrolli dhe rishikimi nga një autoritet më i lartë administrativ ose gjyqësor, duke përfshirë këtu vendimet e formës së prerë dhe kur këto i janë nënshtruar rekursit, si përfundimtar konsiderohet vendimi i Gjykatës së Lartë...” Kjo dispozitë me natyrë procedurale përcakton se kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë dhe bëhet i ekzekutueshëm për qëllime të këtij ligji, në rastin kur mosmarrëveshja midis ish-pronarit dhe shtetit i nënshtrohet juridiksionit gjyqësor. Nga ana tjetër, Kolegji thekson se, kjo dispozitë, për situatën kur gjykata e apelit ka ushtruar juridiksion fillestar, është në harmoni edhe me parashikimin e përgjithshëm të nenit 451 të K.Pr.Civile (lex generalis), sipas të cilit vendimi i gjykatës merr formë të prerë, ndër të tjera, kur është vendosur lënia në fuqi, ndryshimi i vendimit apo është vendosur pushimi i gjykimit në shkallë të dytë (pika ç). Sipas kësaj dispozite vendimi i gjykatës merr formë të prerë pas një procesi gjyqësor dy shkallësh, si rrjedhojë vendimi i gjykatës së apelit civil apo administrativ, në rastet kur gjykata e apelit ushtron juridiksion fillestar, (apo e thënë ndryshe ka gjykuar si shkallë e parë) dhe ndaj vendimit është ushtruar rekurs, nuk mund të konsiderohet si vendim gjyqësor i formës së prerë. Rekursi në këtë rast ka sjellë efektet juridike të parandalimit të marrjes formë të prerë. Si rrjedhojë, vendimi i gjykatës së apelit do të marrë formë të prerë pasi të përfundojë shqyrtimi i rekursit në Gjykatën e Lartë, si shkalla e dytë e gjykimit.

17. Bazuar në arsytimin e mësipërm, në rastin konkret, kërkesa e kërkuesit është pa objekt sepse paraqitja e rekursit ka ipso iure efekte pezulluese për vendimin e dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit. Ky i fundit në rastin konkret nuk është i formës së prerë dhe sikurse u arsyetua më sipër neni 479 i K.Pr.Civile fushën e zbatimit e ka vetëm për vendimet objekt rekursi të gjykatës së apelit me juridiksion rishikues.

18. Kolegji vlerëson të rëndësishme të theksojë se nuk ka patur një praktikë të qartë në lidhje me interpretimin e Ligjit nr. 133/2015, në raport me nenin 451 të K.Pr.Civile, në raste të tilla, në lidhje me çështjen nëse janë apo jo të formës së prerë vendimet e gjykatave të apelit me juridiksion fillestar. Kolegji vlerëson se qëndrimi i mbajtur në rastin konkret, sipas të cilit vendimet e gjykatave civile të apelit apo të Gjykatës Administrative të Apelit me juridiksion fillestar sipas Ligjit nr. 133/2015, do të jetë i zbatueshëm edhe për rastet e ngjashme në të ardhmen (pro futuro). Si rrjedhojë Kolegji thekson se çdo kërkesë e palëve në të ardhmen për pezullimin e ekzekutimit të vendimit sipas nenit 479 të K.Pr.Civile në raste të tilla do të vlerësohet në kuptim të kërkesave të parashikuar në nenin 34 të K.Pr.Civile të ndryshuar.

19. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Agjencia e Trajtimit të Pronave, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.104 (86-2019-1447), datë 25.04.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 *“Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”* dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile

### **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.104 (86-2019-1447), datë 25.04.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Agjencia e Trajtimit të Pronave.

**Tiranë, më datë 22.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**ANËTAR**  
**Illir PANDA**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 85/407 i Vendimit.**

**V E N D I M  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi  
Ervin Pupe  
Ilir Panda**

**Kryesues  
Anëtar  
Anëtar**

Në datën 22.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Ministria e Brendshme

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.351, datë 07.02.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe vendimit nr.453 (80-2017-454), datë 13.02.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479/a të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Drini Nurka

**PADITUR:** Ministria e Brendshme  
Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Drini Nurka, i është drejtuar DRSSH Tiranë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, për përfitimin e pensionit të parakoshëm për vjetërsi shërbimi.

2. Nga ana e palës së paditur DRSSH Tiranë dhe Ministria e Punëve të Brendshme, i kanë kthyer përgjigje se nuk plotëson 15 vite shpërbim siç kërkon ligji, pasi ka vetëm 10 vite.

3. Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr.453 (80-2017-454), datë 13.02.2017 ka vendosur:

Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë së paditësit Drini Nurka.

Shfuqizimin e shkresës nr.D-86/2 prot., datë 23.11.2016 të palës së paditur Ministria e Brendshme, si veprim tjetër administrativ i pabazuar në ligj dhe në prova.

Detyrimin e palës së paditur t'i njohë paditësit Drini Nurka periudhën 22.06.1992-27.05.1998 si punonjës policie, si periudhë vjetërsie në shërbim për përfitim të pensionit të parakohshëm të ushtarakut.

Detyrimin e palës së paditur DRSSH Tiranë të trajtojë paditësin Drini Nurka me pension të parakohshëm nga data 11.04.2016 e në vijim.

Rrëzimin për pjesën tjetër, si të pabazuar në ligj dhe në prova.

5. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.351, datë 07.02.2019 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.453, datë 13.02.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

6. Më datë **04.09.2019** Ministria e Brendshme, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Ministria e Brendshme nuk ka legjitimitet pasiv në këtë çështje dhe nuk mund të ngarkohet me detyrime dhe gjykatat kanë arsyetuar në kundërshtim me nenin 15 dhe 17 të ligjit nr.49/2012 dhe mosformimi i ndërgjyqësisë është cilësuar shkelej e procesit të rregullt ligjor.*
- *Është i gabuar arsyetimi i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë duke përlligjur pretendimet e paditësit për njohjen e vjetërsisë në punë dhe gjykata shprehet për mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet.*
- *Paditësi Drini Nurka rezulton të ketë 10 vite vjetërsi shërbimi si ushtarak aktiv dhe nuk mund të përfitojë pension sipas ligjit.*
- *Kërkojmë pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë deri sa çështja të shqyrtohet pranë Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

7. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

10. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

11. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të

formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Ministria e Brendshme, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

15. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Ministria e Brendshme, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

16. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Ministria e Brendshme, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

17. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Ministria e Brendshme kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

18. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Ministria e Brendshme nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Ministria e Brendshme.

19. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

20. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Ministria e Brendshme, për pezullimin

e ekzekutimit të vendimit nr.351, datë 07.02.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe vendimit nr.453 (80-2017-454), datë 13.02.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “*Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

### **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.351, datë 07.02.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe vendimit nr.453 (80-2017-454), datë 13.02.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të paraqitur nga Ministria e Brendshme.

**Tiranë, më datë 22.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 106/444 i Vendimit.**

**V E N D I M  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

<b>Sokol Sadushi</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Ervin Pupe</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Illir Panda</b>	<b>Anëtar</b>

Në datën 22.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Avokatura e Shtetit

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.177, datë 01.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Sonila Piri

**PADITUR:** Agjencia e Trajtimit të Pronave

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Sonila Piri, është një nga trashëgimtarët ligjor të subjektit të shpronësuar Qazim Piri (Kume Piri), i cili është një nga subjektet e shpronësuara njohur me vendimin nr.1338 datë 29.11.1996, nga KKKP Bashkia Tiranë.

2. Nga ana e palës së paditur Agjencia e Trajtimit të Pronave, është bërë vlerësimi financiar i pasurive të sipërcituar dhe është arritur në konkluzionin, se sipas metodologjisë të parashikuar në nenin 4 dhe 6 i ligjit nr.133/2015 dhe VKM nr.89/2016, konsiderohet i kompensuar.

3. Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.177, datë 01.07.2019 ka vendosur:

Pranimin e padisë së ngritur nga paditësja Sonila Piri si të bazuar në ligj dhe në prova.

Shfuqizimin e vlerësimit financiar të Agjencisë së Trajtimit të Pronave për vendimin nr.1338 datë 29.11.1996 të ish-KKKP Bashkia Tiranë, të subjektit të shpronësuar Kume Piri (trashgimtarët e tij ligjor), publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare nr.41 datë 18.12.2017.

Detyrimin e palës së paditur të bëjë vlerësimin financiar të pronës së paditëses me sipërfaqe totale 1940 m<sup>2</sup>, të njohur me vendimin nr.1338 datë 29.11.1996 të ish-KKKP Bashkia Tiranë, sipas zërit kadastral të kohës së shpronësimit “truall” sipas VKM nr.89 datë 03.02.2016.

5. Më datë **02.10.2019** Avokatura e Shtetit, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Ky vendim është marrë në interpretim të gabuar të ligjit nr.133/2015.*
- *Gjykata ka gabuar kur ka urdhëruar palën e paditur të kryej vlerësimin financiar për sipërfaqen 1940 m<sup>2</sup> truall, pasi pala e paditur nuk ka detyrim që të kryej ri-llogaritje të vlerësimeve financiare, për ato vendime të cilat i ka realizuar njëherë, por vetëm të ekzekutojë vlerën financiare të një vlerësimi përfundimtar.*
- *Gjykata ka arsyetuar gabim kur ka analizuar dispozitat e ligjit nr.7501/1991 nenin 1 dhe neni 5, pasi gjykata ka arsyetuar se livadhet nuk njësohen me tokën bujqësore, por kjo nuk do të thotë që këto njësohen me tokën “truall”.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda duke e ngarkuar palën e paditur me një detyrim në kundërshtim me ligjin nr.133/2015.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtarë apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt

rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin deponon garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtruhet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore pasjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Avokatura e Shtetit, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

14- Duke iu rikthyer rastit konkret, kërkuesi, ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, e cila ka ushtruar juridiksion fillestar dhe ka disponuar mbi një vendim të Agjencisë së Trajtimit të Pronës, bazuar në Ligjin nr. 133/2015 “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave” (në vijim Ligji nr. 133/2015).

15. Kolegji vlerëson se Ligji nr. 133/2015 është me natyrë mikse, sepse përmban norma juridike të karakterit material dhe procedural. Dispozitat materiale përcaktojnë rregullat dhe kriteret mbi bazën e të cilave organi administrativ kompetent (konkretisht ATP), e më tej gjykata do të vendosë mbi kërkesat e ish-pronarëve për njohje dhe kompensim të pronës. Nga ana tjetër, dispozitat procedurale dispijlojnë në mënyrë të posaçme (lex specialis), veprimtarinë e organit administrativ përgjegjës për trajtimin e kërkesave të ish-pronarëve për kompensim të pronës, afatet e veprimit administrativ, të drejtën ankimit dhe afatet e ankimit të subjekteve të procedimit administrativ, për të kundërshtuar vendimet e ATP-së në gjykatë, kompetencën e gjykatave që do të shqyrtojnë këto mosmarrëveshje etj. Në mënyrë të posaçme, ky ligj i ka njohur juridiksion fillestar gjykatave të apelit dhe Gjykatës Administrative të Apelit, sipas neneve 19 dhe 29, kur objekt kontrolli kanë qënë vendime të ATP-së, vendime të ish-KKKP-ve, ish-ZRVKKP-ve apo ish-AKKP-së, që kanë disponuar në lidhje me kërkesën e ish-pronarëve, për njohjen, kthimin apo kompensimin e pronës. (Vendim Njësues nr. 611, datë 07.02.2018 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).

16. Në vijim të këtij arsytimi, Kolegji sjell në vëmendje nenin 5/17 të Ligjit nr. 133/2015, nën titullin **“Përkufizime”**, ku është parashikuar se: *“...Vendim “përfundimtar” është çdo vendim administrativ ose gjyqësor, i cili nuk i nënshtrohet më një procedure kontrolli dhe rishikimi nga një autoritet më i lartë administrativ ose gjyqësor, duke përfshirë këtu vendimet e formës së prerë dhe kur këto i janë nënshtruar rekursit, si përfundimtar konsiderohet vendimi i Gjykatës së Lartë...”* Kjo dispozitë me natyrë procedurale përcakton se kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë dhe bëhet i ekzekutueshëm për qëllime të këtij ligji, në rastin kur mosmarrëveshja midis ish-pronarit dhe shtetit i nënshtrohet juridiksionit gjyqësor. Nga ana tjetër, Kolegji thekson se, kjo dispozitë, për situatën kur gjykata e apelit ka ushtruar juridiksion fillestar, është në harmoni edhe me parashikimin e përgjithshëm të nenit 451 të K.Pr.Civile (lex generalis), sipas të cilit vendimi i gjykatës merr formë të prerë, ndër të tjera, kur është vendosur lënia në fuqi, ndryshimi i vendimit apo është vendosur pushimi i gjykimit në shkallë të dytë (pika ç). Sipas kësaj dispozite vendimi i gjykatës merr formë të prerë pas një procesi gjyqësor dy shkallësh, si rrjedhojë vendimi i gjykatës së apelit civil apo administrativ, në rastet kur gjykata e apelit ushtron juridiksion fillestar, (apo e thënë ndryshe ka gjykuar si shkallë e parë) dhe ndaj vendimit është ushtruar rekurs, nuk mund të konsiderohet si vendim gjyqësor i formës së prerë. Rekursi në këtë rast ka sjellë efektet juridike të parandalimit të marrjes formë të prerë. Si rrjedhojë, vendimi i gjykatës së apelit do të marrë formë të prerë pasi të përfundojë shqyrtimi i rekursit në Gjykatën e Lartë, si shkalla e dytë e gjykimit.

17. Bazuar në arsytimin e mësipërm, në rastin konkret, kërkesa e kërkuetit është pa objekt sepse paraqitja e rekursit ka ipso iure efekte pezulluese për vendimin e dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit. Ky i fundit në rastin konkret nuk është i formës së prerë dhe sikurse u arsyetua më sipër neni 479 i K.Pr.Civile fushën e zbatimit e ka vetëm për vendimet objekt rekursi të gjykatës së apelit me juridiksion rishikues.

18. Kolegji vlerëson të rëndësishme të theksojë se nuk ka patur një praktikë të qartë në lidhje me interpretimin e Ligjit nr. 133/2015, në raport me nenin 451 të K.Pr.Civile, në raste të tilla, në lidhje me çështjen nëse janë apo jo të formës së prerë vendimet e gjykatave të apelit me juridiksion fillestar. Kolegji vlerëson se qëndrimi i mbajtur në rastin konkret, sipas të cilit vendimet e gjykatave civile të apelit apo të Gjykatës Administrative të Apelit me juridiksion fillestar sipas Ligjit nr. 133/2015, do të jetë i zbatueshëm edhe për rastet e ngjashme në të ardhmen (pro futuro). Si rrjedhojë Kolegji thekson se çdo kërkesë e palëve në të ardhmen për pezullimin e ekzekutimit të vendimit sipas nenit 479 të K.Pr.Civile në raste të tilla do të vlerësohet në kuptim të kërkesave të parashikuar në nenin 34 të K.Pr.Civile të ndryshuar.

19. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Avokatura e Shtetit, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.177, datë 01.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile

### **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.177, datë 01.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Avokatura e Shtetit.

**Tiranë, më datë 22.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**ANËTAR**  
**Illir PANDA**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 109/447 i Vendimit.**

**V E N D I M**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi  
Ervin Pupe  
Ilir Panda**

**Kryesues  
Anëtar  
Anëtar**

Në datën 22.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Avokatura e Shtetit

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.155, datë 17.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Luan Hakani, Xhafer Hakani etj

**PADITUR:** Agjencia e Trajtimit të Pronave

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Arben Hakani etj, është një nga trashëgimtarët ligjor të subjektit të shpronësuar Xhaferr Hakani, i cili është një nga subjektet e shpronësuar njohur me vendimin nr.413/2 datë 05.02.21996, ndryshuar me vendimin nr.1301, datë 26.11.1999 nga KKKP Bashkia Elbasan.

2. Nga ana e palës së paditur Agjencia e Trajtimit të Pronave, është bërë vlerësimi financiar i pasurive të sipërcituar dhe është arritur në konkluzionin, se sipas metodologjisë të parashikuar në nenin 4 dhe 6 i ligjit nr.133/2015 dhe VKM nr.89/2016, konsiderohet i kompensuar.

3. Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

**4. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.155, datë 17.06.2019 ka vendosur:

Pranimin e pjesëshëm të padisë.

Shfuqizimin e vlerësimit financiar për pronën e njohur për kompensim në favor të trashëgimtarëve të ish-pronarit Xhafer Hakani përlllogaritur nga A.T.P, për vendimin nr.413/2 datë 05.02.1996 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të ish pronarve Elbasan, ndryshuar me vendimin nr.1379 datë 20.11.1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ndryshuar me vendimin nr.1301 datë 26.11.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare nr.22 datë 21.05.2018, me nr. Rendor 84.

Detyrimin e A.T.P, të kompensojë financiarisht trashëgimtarët ish-pronarit Xhafer Hakani, për sipërfaqen e njohur për kompensim prej 1640 m2 truall në ZK 8522 në vlerën 20 932 960 lekë.

Detyrimin e A.T.P, të kompensojë financiarisht trashëgimtarët ish-pronarit Xhafer Hakani, për sipërfaqen e njohur për kompensim në obligacione prej 415 m2 truall në ZK 8522 në përputhje me kërkesat e ligjit nr.133/2015.

Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të kërtimeve.

5. Më datë **02.10.2019** Avokatura e Shtetit, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Ky vendim është marrë në interpretim të gabuar të ligjit nr.133/2015, konkretisht nenit 19, pasi gjykata duhet të kishte dalë me vendim për mospranim padie në kushtet kur gjatë gjykimit u provua që pala paditëse i është drejtuar gjykatës me padi jashtë afatit ligjor.*
- *Gjykata ka gabuar kur ka urdhëruar palën e paditur të kryej vlerësimin financiar për sipërfaqen 415 m2 truall dhe kompensimin sipas kërkesave të neneve 6.6 dhe 7.2 të ligjit nr.133/2015, pasi këto dispozita që ka referuar gjykata nuk përkojnë me arsyetimin e saj, duke qenë se vendimet e KKKP nuk kanë përcaktuar vlerën e obligacioneve për kompensim.*
- *Ky vendim krijon vështirësi në ekzekutim pasi vjen në kundërshtim me ligjin, pasi pala e paditur nuk ka detyrim që të kryejë ri-llogaritje të vlerësimeve financiare, për ato vendime të cilat i ka realizuar njëherë, por vetëm të ekzekutojë vlerën financiare të një vlerësimi përfundimtar.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda duke e ngarkuar palën e paditur me një detyrim në kundërshtim me ligjin nr.133/2015.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi

masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar



dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjesisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Avokatura e Shtetit, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

14- Duke iu rikthyer rastit konkret, kërkuesi, ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, e cila ka ushtruar juridiksion fillestar dhe ka disponuar mbi një vendim të Agjencisë së Trajtimit të Pronës, bazuar në Ligjin nr. 133/2015 “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave” (në vijim Ligji nr. 133/2015).

15. Kolegji vlerëson se Ligji nr. 133/2015 është me natyrë mikse, sepse përmban norma juridike të karakterit material dhe procedural. Dispozitat materiale përcaktojnë rregullat dhe kriteret mbi bazën e të cilave organi administrativ kompetent (konkretisht ATP), e më tej gjykata do të vendosë mbi kërkesat e ish-pronarëve për njohje dhe kompensim të pronës. Nga ana tjetër, dispozitat procedurale dispijlojnë në mënyrë të posaçme (lex specialis), veprimtarinë e organit administrativ përgjegjës për trajtimin e kërkesave të ish-pronarëve për kompensim të pronës, afatet e veprimit administrativ, të drejtën ankimit dhe afatet e ankimit të subjekteve të procedimit administrativ, për të kundërshtuar vendimet e ATP-së në gjykatë, kompetencën e gjykatave që do të shqyrtojnë këto mosmarrëveshje etj. Në mënyrë të posaçme, ky ligj i ka njohur juridiksion fillestar gjykatave të apelit dhe Gjykatës Administrative të Apelit, sipas neneve 19 dhe 29, kur objekt kontrolli kanë qënë vendime të ATP-së, vendime të ish-KKKP-ve, ish-ZRVKKP-ve apo ish-AKKP-së, që kanë disponuar në lidhje me kërkesën e ish-pronarëve, për njohjen, kthimin apo kompensimin e pronës. (Vendim Njësues nr. 611, datë 07.02.2018 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).

16. Në vijim të këtij arsytimi, Kolegji sjell në vëmendje nenin 5/17 të Ligjit nr. 133/2015, nën titullin “**Përkufizime**”, ku është parashikuar se: “...Vendim “përfundimtar” është çdo vendim administrativ ose gjyqësor, i cili nuk i nënshtrohet më një procedure kontrolli dhe rishikimi nga një autoritet më i lartë administrativ ose gjyqësor, duke përfshirë këtu vendimet e formës së prerë dhe kur këto i janë nënshtruar rekursit, si përfundimtar konsiderohet vendimi i Gjykatës së Lartë...” Kjo dispozitë me natyrë procedurale përcakton se kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë dhe bëhet i ekzekutueshëm për qëllime të këtij ligji, në rastin kur mosmarrëveshja midis ish-pronarit dhe shtetit i nënshtrohet juridiksionit gjyqësor. Nga ana tjetër, Kolegji thekson se, kjo dispozitë, për situatën kur gjykata e apelit ka ushtruar juridiksion fillestar, është në harmoni edhe me parashikimin e përgjithshëm të nenit 451 të K.Pr.Civile (lex generalis), sipas të cilit vendimi i gjykatës merr formë të prerë, ndër të tjera, kur është vendosur lënia në fuqi, ndryshimi i vendimit apo është vendosur pushimi i gjykimit në shkallë të dytë (pika ç). Sipas kësaj dispozite vendimi i gjykatës merr formë të

prerë pas një procesi gjyqësor dy shkallësh, si rrjedhojë vendimi i gjykatës së apelit civil apo administrativ, në rastet kur gjykata e apelit ushtron juridiksion fillestar, (apo e thënë ndryshe ka gjykuar si shkallë e parë) dhe ndaj vendimit është ushtruar rekurs, nuk mund të konsiderohet si vendim gjyqësor i formës së prerë. Rekursi në këtë rast ka sjellë efektet juridike të parandalimit të marrjes formë të prerë. Si rrjedhojë, vendimi i gjykatës së apelit do të marrë formë të prerë pasi të përfundojë shqyrtimi i rekursit në Gjykatën e Lartë, si shkalla e dytë e gjykimit.

17. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, në rastin konkret, kërkesa e kërkuesit është pa objekt sepse paraqitja e rekursit ka ipso iure efekte pezulluese për vendimin e dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit. Ky i fundit në rastin konkret nuk është i formës së prerë dhe sikurse u arsyetua më sipër nën 479 i K.Pr.Civile fushën e zbatimit e ka vetëm për vendimet objekt rekursi të gjykatës së apelit me juridiksion rishikues.

18. Kolegji vlerëson të rëndësishme të theksojë se nuk ka patur një praktikë të qartë në lidhje me interpretimin e Ligjit nr. 133/2015, në raport me nenin 451 të K.Pr.Civile, në raste të tilla, në lidhje me çështjen nëse janë apo jo të formës së prerë vendimet e gjykatave të apelit me juridiksion fillestar. Kolegji vlerëson se qëndrimi i mbajtur në rastin konkret, sipas të cilit vendimet e gjykatave civile të apelit apo të Gjykatës Administrative të Apelit me juridiksion fillestar sipas Ligjit nr. 133/2015, do të jetë i zbatueshëm edhe për rastet e ngjashme në të ardhmen (pro futuro). Si rrjedhojë Kolegji thekson se çdo kërkesë e palëve në të ardhmen për pezullimin e ekzekutimit të vendimit sipas nenit 479 të K.Pr.Civile në raste të tilla do të vlerësohet në kuptim të kërkesave të parashikuar në nenin 34 të K.Pr.Civile të ndryshuar.

19. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Avokatura e Shtetit, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.155, datë 17.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

## **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “*Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

## **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.155, datë 17.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Avokatura e Shtetit.

**Tiranë, më datë 22.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 142/499 i Vendimit**

**V E N D I M**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi  
Ervin Pupe  
Ilir Panda**

**Kryesues  
Anëtar  
Anëtar**

Në datën 22.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Arben Shytaj

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.2178, datë 15.10.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479/1,a,b/4 të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**KËRKUES:** Prefekti i Qarkut Fier

**PERSON I TRETË:** Arben Shytaj

**NDËRHYRËS DYTËSOR:** Theodhor Llazi

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

## I- RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se personi i tretë Arben Shytaj, me AMTP-në nr.14926 datë 06.12.1994 ka përfituar një sipërfaqe prej 14800 m<sup>2</sup>, ndodhur në parcelën nr.29/1, në fshatin Grizë Gordolesh, Patos.

2. Nga ana e palës kërkuese Prefekti i Qarkut Fier, ka nisur një verifikimi i AMTP-në nr.14926 datë 06.12.1994 dhe në përfundim është marrë vendimi nr.77/3 datë 02.06.2012 me të cilin është shpallur pavlefshmëria e këtij akti.

3. Për sa më sipër, pala kërkuese duke pretenduar se personi i tretë ka vepruar në kundërshtim me ligjin duke përfituar tokë padrejtësisht, i është drejtuar gjykatës me kërkesën objekt gjykimi.

4. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier**, me vendimin nr.62-2012-6823 (2431), datë 10.12.2012 ka vendosur:  
Rrëzimin e kërkesës.

5. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.2178, datë 15.10.2015 ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr.62-2012-6823 (2431), datë 10.12.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në këtë mënyrë:

Pranimin e padisë së paditësit Prefekti i Qarkut Fier.

Deklarimin e pavlefshmërisë së Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) me nr.14926, datë 06.12.1994 në emër të z.Arben Haxhi Shytaj, për një sipërfaqe totale prej 14800 m<sup>2</sup>, e ndodhur në ngastrën me nr.29/1.

Shfuqizimin e Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) me nr.14926, datë 06.12.1994.

Detyrimin e z.Arben Haxhi Shytaj që për sipërfaqen përkatëse të tokës së shitur të kryej pagesën e kësaj toke në shumën 3.862.800 (tre milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e tetëqind) lekë.

6. Më datë **18.11.2019** Arben Shytaj, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit kemi bërë rekurs, pasi ky gjykim është bërë në mungesën time dhe unë nuk ka patur mundësi të paraqes prova dhe nuk mund të mbrohesha.*
- *Gjykata ka pranuar kërkesën e Prefektit në një kohë kurë e drejta duhej kërkuar me padi dhe për rrjedhojë smund të pranohej kërkesa sepse kjo vjen në kundërshtim me vendimin nr.161 datë 12.03.2015 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.*
- *Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është vënë në ekzekutim nga ana e Zyrës së Përmbarimit Tiranë mbi kërkesën e qytetarit Margarit Llazi, i cili nuk është as palë kreditore as person i tretë, as ndërhyrës kryesor apo dytësor.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda për familjen time dhe jam gati të garantojë këtë pezullim.*

## II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

7. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

10. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

11. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të

formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Arben Shytaj, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

15. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Arben Shytaj, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

16. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Arben Shytaj, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

17. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Arben Shytaj kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

18. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Arben Shytaj nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Arben Shytaj.

19. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim

dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

20. Ky Kolegj, vlerëson të theksojë qëndrimin e Gjykatës së Lartë, e cila çon automatikisht në rrëzimin e kërkesës si të pambështetur në ligj, se kërkesa për pezullimin e ekzekutimit, nuk është shoqëruar me vendosjen e garancisë në zbatim të nenit 479 pika 1 gërma “b” të K.Pr.Civile.

21. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Arben Shytaj, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2178, datë 15.10.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “*Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

### **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2178, datë 15.10.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Arben Shytaj.

**Tiranë, më datë 22.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr.146/507 i Vendimit.**

**V E N D I M**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi  
Ervin Pupe  
Ilir Panda**

**Kryesues  
Anëtar  
Anëtar**

Në datën 22.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Agjencia Shtetërore e Kadastrës

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.268, datë 17.04.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, lënë në fuqi me vendimin nr.1791, datë 11.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Endri Kotherja etj

**PADITUR:** Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ish ZQRPP/ZVRPP Elbasan)

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Endri Kotherja etj, pretendon se është trashgimtar i Hysen dhe Ahmet Dakli, pronar të pasurisë truall me sipërfaqe 2345 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë (1+2+3+4+5) 487 m<sup>2</sup>, në lagjen Partizani Elbasan.



2. Nga ana e palës së paditur ZVRPP Elbasan me projekt urdhërin nr.6/1 datë 01.11.2016 i është propozuar ZQRPP Tiranë mosregjistrimi i kësaj pasurie, e cila me vendimin nr.173 datë 07.02.2017 ka vendosur miratimin e refuzimit për regjistrim dhe pajisjen me çertifikatë pronësie.

3. Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës**, me vendimin nr.268, datë 17.04.2018 ka vendosur:

1. Pranimin e pjesshëm të padisë të paditësit Endri Kotherja kundër të paditurve Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan.

2. Shfuqizimin e urdhrin nr. 173, datë 7.2.2017, të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

3. Detyrimin e të paditurit Z.V.R.P.P. Elbasan për kryerjen e veprimeve të nevojshme administrative me karakter regjistruar, duke finalizuar me lëshimin e dokumentit të vërtetimit të pronësisë (çertifikatë/vërtetim), për pasurinë e llojit truall me sipërfaqe 2 285m<sup>2</sup>, ndodhur në ZK 8524, sipas përcaktimit të vendndodhjes dhe karakteristikave të pasqyruara në PlanRilevimin, me datë përgatitje 05.03.2018, të ekspertit të palës z. Shpëtim Pashollari, akt i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Rrëzimin e kërimit të drejtuar tek projekturdhri nr. 6/1, datë 1.11.2016, i Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan.

5. Rrëzimin e kërimit në lidhje me diferencën midis sipërfaqeve 2 285 m<sup>2</sup> dhe 2 345 m<sup>2</sup>.

5. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.1791, datë 11.06.2019 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.268, datë 17.04.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

6. Më datë **26.11.2019** Agjencia Shtetërore e Kadastrës, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtrohet sa vijon:

- *ASHK ka ushtruar të drejtën e rekursit në përputhje me afatin ligjor të parashikuar në Kodin e Procedurës Civile.*
- *Nisur nga fakti se çështja është duke u shqyrtuar nga Gjykatën e Lartë dhe ekzekutimi i vendimit do të sillte pasoja të rënda, referuar përcaktimeve të nenit 479 pika 1 gërma "a" të K.Pr.Civile, kërkojmë pezullimin e vendimit deri në shqyrtimin e rekursit.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

7. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ" (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor

të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

10. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

11. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e

tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

15. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Agjencia Shtetërore e Kadastrës, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

16. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të cilët kanë parashtruar argumente lidhur me mos bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe në thelb të qëndrimit të tyre kanë kërkuar mospranimin e kërkesës si të pabazuar në ligj.

17. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Agjencia Shtetërore e Kadastrës kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

18. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Agjencia Shtetërore e Kadastrës nuk ka parashtruar asnjë provë apo argument të lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

19. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar

njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

20. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Agjencia Shtetërore e Kadastrës, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.268, datë 17.04.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, lënë në fuqi me vendimin nr.1791, datë 11.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile

### **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.268, datë 17.04.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, lënë në fuqi me vendimin nr.1791, datë 11.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

**Tiranë, më datë 22.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 161/527 i Vendimit**

**V E N D I M**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi  
Ervin Pupe  
Ilir Panda**

**Kryesues  
Anëtar  
Anëtar**

Në datën 22.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Ndërrmarja “MEICO”

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.4719, datë 13.10.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.3035, datë 14.11.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 dhe 615 të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Hysni Hamolli etj

**PADITUR:** Ministria e Mbrojtjes  
Ndërrmarja “MEICO”  
Shoqëria “Albademil” sh.p.k

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Hysni Hamolli etj, janë trashëgimtar të të ndjerit Azem Hamolli, i cili ka humbur jetën në aksidentin e ndodhur në Gërdec.

2. Për sa më sipër, paditësit duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

3. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr.4719, datë 13.10.2016 ka vendosur:

Pranimin e kërkesë padisë së paraqitur nga paditësat Hysni Hamolli, Qanije Shyti (Hamolli), Nexhmije Pere (Hamolli), Serije Mucka (Hamolli).

Detyrimin e palëve të paditur Ministria e Mbrojtjes, ndërmarrja “MEICO” dhe Shoqëria “Albademil” sh.p.k, që të dëmshpërblejnë në mënyrë solidare paditësin Hysni Hamolli, për dëmin jopasuror (moral dhe ekzistencial) në shumën **2.535.894 lekë (dy milion e pesëqind e tridhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër)**.

Detyrimin e palëve të paditur Ministria e Mbrojtjes, ndërmarrja “MEICO” dhe Shoqëria “Albademil” sh.p.k, që të dëmshpërblejnë në mënyrë solidare paditësen Qanije Shyti (Hamolli), për dëmin jopasuror (moral dhe ekzistencial) në shumën **2.535.894 lekë (dy milion e pesëqind e tridhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër)**.

Detyrimin e palëve të paditur Ministria e Mbrojtjes, ndërmarrja “MEICO” dhe Shoqëria “Albademil” sh.p.k, që të dëmshpërblejnë në mënyrë solidare paditësen Nexhmije Pere (Hamolli), për dëmin jopasuror (moral dhe ekzistencial) në shumën **2.535.894 lekë (dy milion e pesëqind e tridhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër)**.

Detyrimin e palëve të paditur Ministria e Mbrojtjes, ndërmarrja “MEICO” dhe Shoqëria “Albademil” sh.p.k, që të dëmshpërblejnë në mënyrë solidare paditësen Serije Mucka (Hamolli), për dëmin jopasuror (moral dhe ekzistencial) në shumën **2.535.894 lekë (dy milion e pesëqind e tridhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër)**.

4. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.3035, datë 14.11.2019 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.4719, datë 13.10.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

5. Më datë **26.12.2019** Ndërmarrja “MEICO”, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Gjykata në kundërshtim me provat e paraqitura në gjykim ka arritur në konkluzionin se Ndërmarrja “MEICO” legjitimohet pasivisht, pavarësisht se edhe nga vendimi penal edhe nga ai civil, provohet se aktiviteti është kryer nga Shoqëria “Albademil” shpk dhe kompania Amerikane SAC.*
- *Është jashtë logjike të arrihet në konkluzionin se aktiviteti i cili ka shkaktuar aksidentin ka ardhur si pasojë e bashkëpunimit me arritjen e qëllimi të përbashkët, ku qëllimi i secilit subjekt është krejtësisht i ndryshëm dhe Ndërmarrja “MEICO” nuk nuk ka qenë pjesë e procedurave të tjetërsimit të armatimit.*
- *Një tjetër gabim i gjykatës është fakti se nuk merren në shqyrtim pretendimet e palëve të paditura për parashkrimin padisë, pasi bazuar në nenin 112 të Kodit Civil nuk është ushtruar brenda afateve.*

- *Edhe akti i ekspertimit ka gabime në përlllogaritje pasi nuk jemi dakord me përlllogaritjen e dëmit pasuror me pagën mesatare të vitit 2008, e cila për ne është abuzive dhe në dëm të shtetit.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda për shkak të vlerave të mëdha dhe do të shkojmë drejt falimentimit.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkakimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Ndërrmarja “MEICO”, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

14. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Ndërrmarja “MEICO”, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

15. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Ndërrmarja “MEICO”, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

16. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Ndërrmarja “MEICO” kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

17. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Ndërrmarja “MEICO” nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka



arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Ndërrmarja “MEICO”.

18. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

19. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Ndërrmarja “MEICO”, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.4719, datë 13.10.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.3035, datë 14.11.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile

### **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.4719, datë 13.10.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.3035, datë 14.11.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Ndërrmarja “MEICO”.

**Tiranë, më datë 22.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 37/312 i Vendimit.**

**V E N D I M**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi  
Ervin Pupe  
Ilir Panda**

**Kryesues  
Anëtar  
Anëtar**

Në datën 22.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.3539, datë 06.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe vendimit nr.4131, datë 16.11.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Edmond Vila

**PADITUR:** Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Edmond Vila, ka qenë ushtarak prej 1981 dhe pas daljes në rezervë ka paraqitur pranë palës së paditur DRSSH Tiranë kërkesën për pension të parakohshëm për vjetërsi në shërbim.

2. Nga ana e palës së paditur DRSSH Tiranë me vendimin nr.4988 datë 11.12.2008, i është caktuar paditësi pension i parakohshëm për vjetërsi në shërbim në masën 1903 lekë/muaj.

3. Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe pasi ka shteruar ankimin administrativ, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr.3539, datë 06.07.2016 ka vendosur:

Pranimin e kërkesë padisë së paditësit Edmond Vila.

Detyrimin e palës së paditur Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, t`i rillogarisë dhe paguajë paditësit Edmond Vila diferencat e papaguara të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, llogaritur sipas parashikimeve ligjit nr. 9210, datë 23. 03. 2004, ‘Për Statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë’, nga nga data 01.09.2008 deri me datë 01.07.2009, në konsiderim edhe të VKM-ve respektive për rritjen e pensionit të parakohshëm, detyrim i cili, është në masën 191339 lekë (llogaritur si diferencë midis masës së pensionit për vjetërsi shërbimi të rillogaritur, në raport me atë të dhënë nga DRSSH Tiranë).

5. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.4131, datë 16.11.2018 ka vendosur:

Mospranimin e ankimit të palës së paditur Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë kundër vendimit nr.3539, datë 06.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

6. Më datë **30.05.2019** Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Pas përfundimit të procesit gjyqësor në Gjykatën e Apelit Administrativ nga ana e DRSSH Tiranë është ushtruar rekurs me shkresën nr.4741 prot., datë 11.12.2018.*
- *Ky vendim nuk mund të vihet në zbatim nga ana e DRSSH pasi duke filluar nga hyrja në fuqi e vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë nr.3 datë 24.11.2016, është në kundërshtim me këtë vendim.*
- *Gjykata Administrative e Apelit pasi u vu në dijeni të këtij vendim nuk e mori parasysh, pasi llogaritja e përfitimeve ka ndryshuar totalisht duke u kufizuar në masën totale në mbështetje të ligjit nr.8087/1996 i ndryshuar.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda ekonomike dhe një precedent të rrezikshëm.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

7. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm,

sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkakimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

10. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

11. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese

duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

15. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

16. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

17. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

18. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

19. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar

njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

20. Gjithashtu ky Kolegji vlerëson të theksojë se marrja e masës së pezullimi të një vendim të formës së prerë është e lidhur ngushtësisht me zbatimin e dispozitave konkrete mbi ankimin apo rekursin, konkretisht neni 45 dhe neni 56 të ligjit procedural nr.49/2012 “*Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*”, respektimi i të cilit është detyrim për çdo gjykatë apo palë ndërgjyqëse. Kushtet e parashikuara nga ligji procedural mbi të drejtën për të ushtruar rekurs dhe kufizimet e parashikuara prej tij, janë të detyrueshme për zbatim, pasi nga respektimi i tyre varet dhe zgjidhja e çështjeve objekt shqyrtimi.

21. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.3539, datë 06.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe vendimit nr.4131, datë 16.11.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “*Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

### **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.3539, datë 06.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe vendimit nr.4131, datë 16.11.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

**Tiranë, më datë 22.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 178 i Vendimit.**

**V E N D I M  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

<b>Sokol Sadushi</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Ervin Pupe</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Ilir Panda</b>	<b>Anëtar</b>

në Tiranë, sot më **datë 22.06.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me **Nr. Akti 178/2020**, që i përket:

**KËRKUES:** Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

**OBJEKTI:** Pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 2747, datë 17.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

**Në çështjen me palë:**

**PADITËS:** Elda Radhima.

**E PADITUR:** Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

**V Ë R E N**

**I. Rrethanat e çështjes**

1. Pala paditëse i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar nga pala e paditur pagimin e dëmshpërblimit për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës.

2. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë**, me vendimin nr. 276 (296), datë 04.03.2016, ka vendosur:

- *Pranimin e pjesshëm të padisë.*

- *Detyrimin e palës së paditur që t'i paguajë paditëses, Elda Radhima, një dëmshpërblim prej 2 (dy) muaj pagë për shkak të zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës.*
- *Detyrimin e palës së paditur që t'i paguajë paditëses një shpërblim prej 2 (dy) muaj pagë për mosrespektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës.*
- *Detyrimin e palës së paditur që t'i paguajë paditëses një dëmshpërblim prej 2 (dy) muaj pagë për mosrespektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës.*
- *Rrëzimin për pjesën tjetër të padisë.*
- *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.*

**3. Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 2747, datë 17.10.2019, ka vendosur:

- *Ndryshimin pjesërisht të vendimit nr. 276 (296), datë 04.03.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.*
- *Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësen, Elda Radhima, me 1 (një) pagë mujore, për zgjidhje të menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës.*
- *Lënien në fuqi të vendimit për disponimet e tjera.*

**4. Kundër vendimit nr. 2747, datë 17.10.2019**, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

**5. Pala e paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës**, në datën 29.01.2020, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 276 (296), datë 04.03.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, ndryshuar me vendimin nr. 2747, datë 17.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda financiare për institucionin tonë.

## **II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë**

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “*Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ*” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.



8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se pala tjetër pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, është njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese dhe nuk ka parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e saj.

13. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se kjo kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe

në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

14. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda për palën kërkuese.

15. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumente dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

### **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës së palës së paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 276 (296), datë 04.03.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, ndryshuar me vendimin nr. 2747, datë 17.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

**Tiranë, më 22.06.2020**

**A N Ë T A R**  
**Ilir PANDA**

**A N Ë T A R**  
**Ervin PUPE**

**K R Y E S U E S**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 192 i Vendimit.**

**V E N D I M  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

<b>Sokol Sadushi</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Ervin Pupe</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Ilir Panda</b>	<b>Anëtar</b>

në Tiranë, sot më **datë 22.06.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me **Nr. Akti 192/2020**, që i përket:

**KËRKUES:** Bashkia Maliq.

**OBJEKTI:** Pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë deri në përfundim të gjykimit nga Gjykata e Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

**Në çështjen me palë:**

**PADITËS:** Selvi Osmanllari.

**E PADITUR:** Bashkia Maliq.

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

**V Ë R E N**

**I. Rrethanat e çështjes**

1. Pala paditëse i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, duke kërkuar nga pala e paditur pagimin e dëmshpërblimit për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës.

2. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë**, me vendimin nr. 84 (187), datë 07.03.2016, ka vendosur:

- *Pranimin pjesërisht të padisë.*

- *Detyrimin e palës së paditur Bashkia Maliq t'i paguajë paditëses Selvi Osmanllari 4 muaj pagë si shpërblim për vjetërsi në punë.*
- *Rrëzimin e padisë lidhur me kërkimet e tjera në padi si të pabazuar në prova dhe në ligj.*

3. **Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 2734, datë 17.10.2019, ka vendosur:

- *Ndryshimin pjesërisht të vendimit nr. 84 (187), datë 07.03.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.*
- *Detyrimin e të paditurit Bashkia Maliq, të dëmshpërblejë paditësen Selvi Osmanllari me:*
  - *12 (dymbëdhjetë) paga mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit të zgjidhjes së kontratës së punës;*
  - *3 (tre) paga mujore për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës;*
  - *2 (dy) paga mujore për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës;*
- *Lënien në fuqi të vendimit për dispozitat e tjera.*

4. **Kundër vendimit nr. 2734, datë 17.10.2019**, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Bashkia Maliq, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 84 (187), datë 07.03.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

5. **Pala e paditur, Bashkia Maliq**, në datën 18.02.2020, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 84 (187), datë 07.03.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, ndryshuar me vendimin nr. 2734, datë 17.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Vendimet e gjykatave janë të pabazuara në ligj dhe në prova, për shkaqet që janë parashtruar në rekurs nga ana e Bashkisë Maliq.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit të formës së prerë do të ketë efekte financiare të konsiderueshme për Bashkinë Maliq.*

## II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “*Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ*” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënie të vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të

pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit.”.*

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtuara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Gjithashtu, ky Kolegji vëren se pala tjetër pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, është njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese dhe nuk ka parashtuar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e saj.

13. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se kjo kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

14. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda për palën kërkuese.

15. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumente dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

## **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

## **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës së palës së paditur, Bashkia Maliq, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 84 (187), datë 07.03.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, ndryshuar me vendimin nr. 2734, datë 17.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

**Tiranë, më 22.06.2020**

**A N Ë T A R**  
**Ilir PANDA**

**A N Ë T A R**  
**Ervin PUPE**

**K R Y E S U E S**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 90/417 i Vendimit.**

**V E N D I M  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

**Sokol Sadushi  
Ervin Pupe  
Ilir Panda**

**Kryesues  
Anëtar  
Anëtar**

në Tiranë, sot më **datë 22.06.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me **Nr. Akti 417/2019**, që i përket:

**KËRKUES:** Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit, Bashkia Tiranë.

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të titullit ekzekutiv, vendimit nr. 4772, datë 17.10.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 1429, datë 09.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

**Në çështjen me palë:**

**PADITËS:** Afërdita Metaliaj.

**E PADITUR:** Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit, Bashkia Tiranë.

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

**V Ë R E N**

**I. Rrethanat e çështjes**

1. Pala paditëse i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar nga pala e paditur pagimin e dëmshpërblimit për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës.

2. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr. 4772, datë 17.10.2016, ka vendosur:

- *Rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.*

3. **Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 1429, datë 09.05.2019, ka vendosur:

- *Ndryshimin e vendimit nr. 4772, datë 17.10.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në këtë mënyrë:*
  - *Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit, Bashkia Tiranë, të dëmshpërblejë paditësen Afërdita Metaliaj me 7 (shtatë) paga mujore, për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme pa shkaqe të justifikuara.*
  - *Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit, Bashkia Tiranë, të dëmshpërblejë paditësen Afërdita Metaliaj me 2 (dy) paga mujore, për mosrespektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës.*
  - *Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit, Bashkia Tiranë, të dëmshpërblejë paditësen Afërdita Metaliaj me 1.5 (një pikë pesë) paga mujore për vjetërsinë në punë.*
  - *Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të kërtimeve.*

4. **Kundër vendimit nr. 1429, datë 09.05.2019**, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit, Bashkia Tiranë, e cila ka kërkuar prishjen e këtij dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 4772, datë 17.10.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

5. **Pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit, Bashkia Tiranë**, në datën 09.09.2019, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 4772, datë 17.10.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 1429, datë 09.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- Vendimi nr. 1429, datë 09.05.2019, i Gjykatës Administrative të Apelit, është dhënë në kundërshtim me ligjin dhe provat e administruara në gjykim.
- Ekziston një rrezik i rëndë dhe i pariparueshëm nga ekzekutimi i vendimit pasi nga bllokimi i llogarive bankare bllokohet veprimtaria dhe funksionimi normal i institucionit.

## **II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë**

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënie të vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.



7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore pasjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se pala tjetër pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, është njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese dhe nuk ka parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e saj.

13. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se kjo kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

14. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda për palën kërkuese.

15. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumente dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

## **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

## **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit, Bashkia Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 4772, datë 17.10.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 1429, datë 09.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

**Tiranë, më 22.06.2020**

**A N Ë T A R**  
**Ilir PANDA**

**A N Ë T A R**  
**Ervin PUPE**

**K R Y E S U E S**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 184 i Vendimit.**

**V E N D I M  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

<b>Sokol Sadushi</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Ervin Pupe</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Ilir Panda</b>	<b>Anëtar</b>

në Tiranë, sot më **datë 22.06.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me **Nr. Akti 184/2020**, që i përket:

**KËRKUES:** Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme pranë Bashkisë Tiranë.

**OBJEKTI:** Kërkesë për pezullimin e vendimit nr. 2825, datë 30.10.2019 nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

**Në çështjen me palë:**

**PADITËS:** Dylbere Hysenaj.

**E PADITUR:** Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme pranë Bashkisë Tiranë.

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

**V Ë R E N**

**I. Rrethanat e çështjes**

1. Pala paditëse i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar nga pala e paditur pagimin e dëmshpërblimit për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës.

2. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr. 2002, datë 11.05.2017, ka vendosur:

- *Pranimin e pjesshëm të padisë.*

- Detyrimin e të paditurit t'i paguajë paditëses 3 (tre) muaj pagë për mosrespektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës.
- Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditëses 2 (dy) muaj pagë për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës.
- Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditëses 4.5 (katër pikë pesë) muaj pagë, si shpërblim për vjetërsi në punë.
- Detyrimin e të paditurit t'i paguajë paditëses 8 (te) muaj pagë, si dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar.
- Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera të saj, si dhe për të paditurin Bashkia Tiranë.

3. **Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 2825, datë 30.10.2019, ka vendosur:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 2002, datë 11.05.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

4. **Kundër vendimit nr. 2825, datë 30.10.2019**, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme pranë Bashkisë Tiranë, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 2002, datë 11.05.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe rrëzimin e padisë.

5. **Pala e paditur, Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme pranë Bashkisë Tiranë**, në datën 05.02.2020, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 2002, datë 11.05.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2825, datë 30.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- Referuar nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile, në kushtet kur kemi një kontratë pune të firmosur nga paditësja në pozicionin Sanitare, titulli ekzekutiv, vendimi gjyqësor, në këtë rast bëhet i pavlefshëm.
- Duke qenë se për Qarqet Durrës dhe Tiranë është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore me VKM-në nr. 750, datë 27.11.2009, ndodhemi në kushtet e pamundësisë së ekzekutimit të detyrimit ndaj kreditorës.

## II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë

mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se pala tjetër pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, është njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese dhe nuk ka parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e saj.

13. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se kjo kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

14. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda për palën kërkuese.

15. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumente dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

### **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës së palës së paditur, Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme pranë Bashkisë Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 2002, datë 11.05.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2825, datë 30.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

**Tiranë, më 22.06.2020**

**A N Ë T A R**  
**Ilir PANDA**

**A N Ë T A R**  
**Ervin PUPE**

**K R Y E S U E S**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 199 i Vendimit.**

**V E N D I M  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

**Sokol Sadushi  
Ervin Pupe  
Irir Panda**

**Kryesues  
Anëtar  
Anëtar**

në Tiranë, sot më **datë 22.06.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me **Nr. Akti 199/2020**, që i përket:

**KËRKUES:** Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit, e Bashkisë Tiranë.

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të titullit ekzekutiv, vendimit nr. 2733, datë 17.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të vendimit nr. 1009, datë 04.03.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

**Në çështjen me palë:**

**PADITËS:** Fiqirije Nezaj.

**E PADITUR:** Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit, Bashkia Tiranë.

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

**V Ë R E N**

**I. Rrethanat e çështjes**

1. Pala paditëse i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar nga pala e paditur pagimin e dëmshpërblimit për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës.

2. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr. 1009 (80-2016-1023), datë 04.03.2016, ka vendosur:

- *Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë së palës paditëse Fiqirije Nezaj.*
- *Konstatimin e zgjidhjes së kontratës së punës me efekt të menjëhershëm dhe pa shkaqe të justifikuara.*
- *Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditëses Fiqirije Nezaj dëmshpërblim në masën e 7 (shtatë) pagave mujore, për shkak të zgjidhjes së menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës.*
- *Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditëses Fiqirije Nezaj dëmshpërblim për mosrespektim të afatit të njoftimit në zgjidhjen e kontratës së punës në masën e 2 (dy) pagave mujore.*
- *Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditëses Fiqirije Nezaj dëmshpërblim për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së marrëdhënies së punës në masën e 2 (pagave) mujore.*
- *Rrëzimin e padisë për pikën e parë të objektit të padisë.*

3. **Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 2733, datë 17.10.2019, ka vendosur:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr. 1009 (1023), datë 04.03.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*

4. **Kundër vendimit nr. 2733, datë 17.10.2019**, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit, e Bashkisë Tiranë, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 1009 (80-2016-1023), datë 04.03.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe pushimin e çështjes.

5. **Pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit, e Bashkisë Tiranë**, në datën 26.02.2020, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1009 (80-2016-1023), datë 04.03.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2733, datë 17.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- Vendimet e gjykatave janë të pabazuara në ligj dhe në prova, për shkaqet që janë parashtruar në rekurs nga ana jonë.
- Ekziston rreziku i shkaktimit të një dëmi ndaj nesh pasi nga zyra përmbartimore është kërkuar zbatimi i vendimit të gjykatës.
- Nga urdhri i nxjerrë nga përmbartimi bankat e nivelit të dytë do të vendosin sekuestro konservative ndaj llogarive tona.
- Ekziston rreziku i rëndë dhe i pariparueshëm, pasi bllokimi i llogarive të drejtorisë bllokoi veprimtarinë dhe funksionimin normal të institucionit tonë, duke i sjellë kështu çorganizim të punës dhe duke i shkaktuar shumë dëme imazhit dhe në vlera monetare.

## **II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë**

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto



mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për

pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se pala tjetër pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, është njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese dhe nuk ka parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e saj.

13. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se kjo kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

14. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda për palën kërkuese.

15. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumente dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

## **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

## **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës së palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit, e Bashkisë Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1009 (80-2016-1023), datë 04.03.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2733, datë 17.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

**Tiranë, më 22.06.2020**

**A N Ë T A R**  
**Ilir PANDA**

**A N Ë T A R**  
**Ervin PUPE**

**K R Y E S U E S**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 198 i Vendimit.**

**V E N D I M  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

<b>Sokol Sadushi</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Ervin Pupe</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Ilir Panda</b>	<b>Anëtar</b>

në Tiranë, sot më **datë 22.06.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me **Nr. Akti 198/2020**, që i përket:

**KËRKUES:** Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit, e Bashkisë Tiranë.

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të titullit ekzekutiv, vendimit nr. 2949, datë 07.11.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të vendimit nr. 269, datë 28.01.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

**Në çështjen me palë:**

**PADITËS:** Guxim Toska.

**E PADITUR:** Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit, Bashkia Tiranë.

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

**V Ë R E N**

**I. Rrethanat e çështjes**

1. Pala paditëse i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar nga pala e paditur pagimin e dëmshpërblimit për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës.

2. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr. 269 (80-2016-177), datë 28.01.2016, ka vendosur:

- *Pranimin e pjesshëm të padisë.*
- *Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditësit dy muaj pagë për mosrespektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës.*
- *Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditësit dy muaj pagë si shpërblim për vjetërsi në punë.*
- *Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditësit nëntë muaj pagë, si dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar.*
- *Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera.*
- *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të të paditurit për pjesën e pranuar të padisë ndërsa për pjesën e rrëzuar të padisë i ngarkohen paditësit.*

3. **Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 2949, datë 07.11.2019, ka vendosur:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr. 269, datë 28.01.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*

4. **Kundër vendimit nr. 2733, datë 17.10.2019**, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit, e Bashkisë Tiranë, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 269 (80-2016-177), datë 28.01.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe pushimin e çështjes.

5. **Pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit, e Bashkisë Tiranë**, në datën 26.02.2020, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 269 (80-2016-177), datë 28.01.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2949, datë 07.11.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Vendimet e gjykatave janë të pabazuara në ligj dhe në prova, për shkaqet që janë parashtruar në rekurs nga ana jonë.*
- *Ekziston rreziku i shkaktimit të një dëmi ndaj nesh pasi nga zyra përmbarimore është kërkuar zbatimi i vendimit të gjykatës.*
- *Nga urdhri i nxjerrë nga përmbarimi bankat e nivelit të dytë do të vendosin sekuestro konservative ndaj llogarive tona.*
- *Ekziston rreziku i rëndë dhe i pariparueshëm, pasi bllokimi i llogarive të drejtorisë bllokoi veprimtarinë dhe funksionimin normal të institucionit tonë, duke i sjellë kështu çorganizim të punës dhe duke i shkaktuar shumë dëme imazhit dhe në vlera monetare.*

## **II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë**

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto

mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për

pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se pala tjetër pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, është njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese dhe nuk ka parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e saj.

13. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se kjo kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

14. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda për palën kërkuese.

15. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumente dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

## **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

## **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës së palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit, e Bashkisë Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 269 (80-2016-177), datë 28.01.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2949, datë 07.11.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

**Tiranë, më 22.06.2020**

**A N Ë T A R**  
**Ilir PANDA**

**A N Ë T A R**  
**Ervin PUPE**

**K R Y E S U E S**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 174 i Vendimit.**

**V E N D I M  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

**Sokol Sadushi  
Ervin Pupe  
Ilir Panda**

**Kryesues  
Anëtar  
Anëtar**

në Tiranë, sot më **datë 22.06.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me **Nr. Akti 174/2020**, që i përket:

**KËRKUES:** Bashkia e Tiranës.

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 5886, datë 09.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2719, datë 17.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 449, 479/a të Kodit të Procedurës Civile.

**Në çështjen me palë:**

**PADITËS:** Myslym Haka.

**E PADITUR:** Bashkia e Tiranës.

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

**V Ë R E N**

**I. Rrethanat e çështjes**

1. Pala paditëse i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar nga pala e paditur pagimin e dëmshpërblimit për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës.

2. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr. 5886, datë 09.12.2016, ka vendosur:

- *Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë të paraqitur nga paditësi Myslym Haka.*
- *Detyrimin e palëve të paditura Bashkia Tiranë dhe Njësia Administrative Petrelë, që të dëmshpërblejë paditësin Myslym Haka me 10 (dhjetë) paga mujore për zgjidhje të menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës, me 2 (dy) paga mujore për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, me 3 (tre) paga mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit si dhe me 4.5 (katër paga e gjysmë) mujore si shpërblim për vjetërsi në punë, gjithsej 19.5 (nëntëmbëdhjetë paga e gjysmë) mujore.*
- *Dëmshpërblimi i mësipërm të llogaritet mbi bazën e pagës bruto mujore që ka pasur paditësi në momentin e përfundimit të marrëdhënieve të punës.*
- *Detyrimin e palëve të paditura që t'i paguajnë paditësit Myslym Haka lejen vjetore për vitin 2015 në raport me kohën e punës së kryer.*
- *Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të objektit, si të pabazuar në ligj.*
- *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.*

3. **Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 2719, datë 17.10.2019, ka vendosur:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr. 5886, datë 09.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*

4. **Kundër vendimit nr. 2719, datë 17.10.2019**, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Bashkia e Tiranës, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 5886, datë 09.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e padisë.

5. **Pala e paditur, Bashkia e Tiranës**, në datën 24.01.2020, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 5886, datë 09.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2719, datë 17.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Vendimet e gjykatave janë të pabazuara në ligj dhe në prova, për shkaqet që janë parashtruar në rekurs nga ana e Bashkisë Tiranë.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit të formës së prerë do të ketë efekte financiare të konsiderueshme për Bashkinë e Tiranës.*

## **II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë**

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo



vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se pala tjetër pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, është njoftuar rregullisht për

kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese dhe nuk ka parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e saj.

13. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se kjo kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

14. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda për palën kërkuese.

15. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumente dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

## **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

## **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës së palës së paditur, Bashkia e Tiranës, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 5886, datë 09.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2719, datë 17.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

**Tiranë, më 22.06.2020**

**A N Ë T A R**  
**Ilir PANDA**

**A N Ë T A R**  
**Ervin PUPE**

**K R Y E S U E S**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 95/424 i Vendimit.**

**V E N D I M  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

**Sokol Sadushi  
Ervin Pupe  
Ilir Panda**

**Kryesues  
Anëtar  
Anëtar**

në Tiranë, sot më **datë 22.06.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me **Nr. Akti 424/2019**, që i përket:

**KËRKUES:** Bashkia Tiranë.

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 423, datë 05.02.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që është ndryshuar pjesërisht me vendimin nr. 4594, datë 14.12.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 449, 479/a të Kodit të Procedurës Civile.

**Në çështjen me palë:**

**PADITËS:** Ndoc Ulndreaj.

**E PADITUR:** Bashkia Tiranë.

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

**V Ë R E N**

**I. Rrethanat e çështjes**

1. Pala paditëse i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar nga pala e paditur pagimin e dëmshpërblimit për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës.

2. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr. 423 (80-2016-401), datë 05.02.2016, ka vendosur:

- *Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë.*
- *Detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë, t'i paguajë paditësit Ndoc Ulndreaj si dëmshpërblim pagën e 8 (tetë) muajve, për shkak të zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës.*
- *Detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë, t'i paguajë paditësit Ndoc Ulndreaj si dëmshpërblim pagën e 2 (dy) muajve punë për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës.*
- *Detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë, t'i paguajë paditësit Ndoc Ulndreaj si dëmshpërblim pagën e 2 (dy) muajve punë për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit të zgjidhjes së kontratës së punës.*
- *Rrëzimin e kërkesëpadisë në lidhje me kërkimet e tjera si të pabazuar në ligj dhe në prova.*

3. **Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 4594, datë 14.12.2018, ka vendosur:

- *Ndryshimin e vendimit nr. 423, datë 05.02.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*
- *Pranimin e pjesshëm të padisë.*
- *Anulimin e aktit administrativ, shkresë nr. 15653/1, datë 09.11.2015, "vendim për zgjidhje të kontratës së punës z. Ndoc Ulndreaj", të Bashkisë Tiranë, si të nxjerrë në kundërshtim me ligjin.*
- *Detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë, t'i paguajë paditësit Ndoc Ulndreaj dëmshpërblimin në masën e 12 (dymbëdhjetë) pagave mujore.*
- *Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera.*

4. **Kundër vendimit nr. 4594, datë 14.12.2018**, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Bashkia Tiranë, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 423 (80-2016-401), datë 05.02.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe rrëzimin e padisë.

5. **Pala e paditur, Bashkia Tiranë**, në datën 19.09.2019, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 423 (80-2016-401), datë 05.02.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 4594, datë 14.12.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Vendimet e gjykatave nuk janë te drejta dhe te bazuara në ligj, pasi zgjidhja e kontratës së punës me paditësin është bërë për shkaqe të justifikuara.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të krijonte pasoja të rënda e të pariparueshme.*

## **II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë**

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ" (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor

të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të

formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se pala tjetër pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, është njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese dhe nuk ka parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e saj.

13. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se kjo kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

14. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda për palën kërkuese.

15. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumente dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

## **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

## **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga pala e paditur, Bashkia Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 423 (80-2016-401), datë 05.02.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 4594, datë 14.12.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit.

**Tiranë, më 22.06.2020**

**A N Ë T A R**  
**Ilir PANDA**

**A N Ë T A R**  
**Ervin PUPE**

**K R Y E S U E S**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 191 i Vendimit.**

**V E N D I M  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

<b>Sokol Sadushi</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Ervin Pupe</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Ilir Panda</b>	<b>Anëtar</b>

në Tiranë, sot më **datë 22.06.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me **Nr. Akti 191/2020**, që i përket:

**KËRKUES:** Këshilli i Qarkut Korçë.

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 318, datë 15.06.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, ndryshuar me vendimin nr. 2816, datë 30.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile.

**Në çështjen me palë:**

**PADITËS:** Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.  
Avokatura e Shtetit

**TË PADITUR:** Bashkia Pogradec, Njësia Administrative Udënisht.  
Këshilli i Qarkut Korçë.

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

**V Ë R E N**

**I. Rrethanat e çështjes**

1. Pala paditëse i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative të palës

së paditur dhe si rrjedhojë e kësaj detyrimit të ZVRPP që të mos kryejë veprimin administrativ të regjistrimit të objektit.

**2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë**, me vendimin nr. 318, datë 15.06.2015, ka vendosur:

- *Rrëzimin e padisë, si të pabazuar në prova dhe në ligj.*
- *Shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të palës paditëse.*

**3. Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 2816, datë 30.10.2019, ka vendosur:

- *Ndryshimin e vendimit nr. 318, datë 15.06.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, në këtë mënyrë:*
- *Pranimin e padisë.*
- *Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 31, datë 07.08.2013, të KRRT-së Qarku Korçë.*
- *Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 02/9, datë 21.06.2006, të KRRT-së Komuna Udenisht për “Rifreskim i vendimit nr. 31/VI/8, datë 07.08.2003, të KRRT-së së Qarkut Korçë, për miratim leje ndërtimi dhe shtesë kati.*
- *Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 1, datë 28.09.2011, të KRRT-së Komuna Udenisht, “Për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij”, për z. Ardian Lekaj.*
- *Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 1, datë 25.09.2012, të Kryetarit të Komunës Udenisht, me të cilën është miratuar “Zgjatje të afatit të lejes së ndërtimit për: Leje e ndërtimit për sh.p.k. “Anker Konstruktion”, për objektin “Bar-Restaurant-Hotel 6kt + nënçati”.*
- *Prishjen e vendimit nr. 318, datë 15.06.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe pushimin e gjykimit në lidhje me kërkimin për anulimin e lejes së përdorimit datë 13.04.2014, të lëshuar nga Kryetari i Komunës Udenisht për objektin “Bar-Restaurant-Hotel 7 kat”, me investitor “Fisku Construction” sh.p.k. dhe zotërues të sheshit të ndërtimit z. Ardian Lekaj si dhe në lidhje me kërkimin për detyrimin e ZVRPP Pogradec për të mos kryer veprimin administrativ të regjistrimit të objektit sipas kërkesës nr. 413 prot, datë 31.03.2014, të Komunës Udenisht.*
- *Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palëve të paditura solidarisht.*

**4. Kundër vendimit nr. 2816, datë 30.10.2019**, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Këshilli i Qarkut Korçë, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi pushimin e gjykimit për të paditurin Këshilli i Qarkut Korçë.

**5. Pala e paditur, Këshilli i Qarkut Korçë**, në datën 18.02.2020, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 318, datë 15.06.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, ndryshuar me vendimin nr. 2581 (86-2019-2950), datë 01.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Vendimet e gjykatave janë të pabazuara në ligj dhe në prova, për shkaqet që janë parashtruar në rekurs nga ana e Bashkisë Tiranë.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit të formës së prerë do të ketë efekte financiare të konsiderueshme për Bashkinë e Tiranës.*

## **II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë**



6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një

dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore pasjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese dhe nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e saj.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, së pari, pala kërkuese ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të një vendimi i cili nuk përmban ndonjë detyrim. Referuar objektit të mosmarrëveshjes rezulton se kemi të bëjmë me një padi njohje, e cila si rezultat prodhon një vendim njohje. Edhe pse pala paditëse në padinë e saj ka kërkuar detyrimin e ZVRPP që të mos kryejë veprimin administrativ të regjistrimit të objektit përkatës, kjo sërish nuk e ndryshon natyrën e mosmarrëveshjes, pasi një kërkim i tillë, referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë por edhe Vendimit Unifikues nr. 4, datë 10.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të kësaj Gjykate, nuk qëndron i mëvetësishëm dhe nuk përbën një kërkim në vetvete, por është rrjedhojë e drejtpërdrejt dhe e domosdoshme e kërimit të parë me natyrë njohëse të së drejtës.

14. Në të njëjtën kohë, nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se kjo kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

15. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda për palën kërkuese.

16. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumente dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

## **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

## **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës së palës së paditur, Këshilli i Qarkut Korçë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 318, datë 15.06.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, ndryshuar me vendimin nr. 2816 datë 30.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

**Tiranë, më 22.06.2020**

**A N Ë T A R**  
**Ilir PANDA**

**A N Ë T A R**  
**Ervin PUPE**

**K R Y E S U E S**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 150/512 i Vendimit.**

**V E N D I M  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

**Sokol Sadushi  
Ervin Pupe  
Ilir Panda**

**Kryesues  
Anëtar  
Anëtar**

në Tiranë, sot më **datë 22.06.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me **Nr. Akti 512/2019**, që i përket:

**KËRKUES:** Spitali Rajonal Lezhë.

**OBJEKTI:** Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 2351, datë 12.09.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit deri në shqyrtimin e çështjes dhënien e vendimit përfundimtar.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 479 i Kodit të Procedurës Civile.

**Në çështjen me palë:**

**PADITËS:** Margarita Nikolli.

**I PADITUR:** Spitali Rajonal Lezhë.

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

**V Ë R E N**

**I. Rrethanat e çështjes**

1. Pala paditëse i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar nga pala e paditur pagimin e dëmshpërblimit për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, me vendimin nr. 15 (12), datë 12.01.2017, ka vendosur:

- *Pranimin e pjeshëm të kërkesëpadisë.*
- *Detyrimin e palës së paditur Drejtoria Rajonale e Spitalit Lezhë të dëmshpërblejë paditësen Margarita Nikolli me dy paga mujore për mosrespektim të procedurës së njoftimit konform nenit 144/5 të Kodit të Punës.*
- *Rrëzimin për pjesën tjetër të kërkesëpadisë.*

3. **Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 2351, datë 12.09.2019, ka vendosur:

- *Ndryshimin e vendimit nr. 15 (12), datë 12.01.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.*
- *Pranimin e pjeshëm të padisë së paditëses Margarita Nikolli.*
- *Detyrimin e palës së paditur Spitali Rajonal Lezhë t'i paguajë paditëses Margarita Nikolli një dëmshpërblim në masën e gjashtë pagave mujore për shkak të zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës.*
- *Detyrimin e palës së paditur Spitali Rajonal Lezhë t'i paguajë paditëses Margarita Nikolli pagën për periudhën 16.07.2016 – 31.10.2016, për shkak të moszbatimit të njoftimit të zgjidhjes së kontratës së punës.*
- *Detyrimin e palës së paditur Spitali Rajonal Lezhë t'i paguajë paditëses Margarita Nikolli dy paga mujore si dëmshpërblim për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës.*
- *Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të kërkesës.*

4. **Kundër vendimit nr. 2351, datë 12.09.2019**, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Spitali Rajonal Lezhë, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 15 (12), datë 12.01.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, dhe kthimin e çështjes për rigjykim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

5. **Pala e paditur, Spitali Rajonal Lezhë**, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë, së bashku me rekursin, edhe kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 15 (12), datë 12.01.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, ndryshuar me vendimin nr. 2351, datë 12.09.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Vendimet e gjykatave janë marr në interpretim dhe zbatim të gabuar të dispozitave të Kodit të Punës.*
- *Vendimi duhet të pezullohet edhe për faktin se buxheti i Spitalit Rajonal Lezhë për vitin 2019 është miratuar në Dhjetor 2018 dhe ka qenë pa mundur parashikimi i likuiditeteve për vendime gjyqësore të pashpallura.*

## **II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë**

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se pala tjetër pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, është njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese dhe nuk ka parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e saj.

13. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se kjo kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

14. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda për palën kërkuese.

15. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumente dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

## **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

## **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga pala e paditur, Spitali Rajonal Lezhë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 15 (12), datë 12.01.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, ndryshuar me vendimin nr. 2351, datë 12.09.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

**Tiranë, më 22.06.2020**

**A N Ë T A R**  
**Ilir PANDA**

**A N Ë T A R**  
**Ervin PUPE**

**K R Y E S U E S**  
**Sokol SADUSHI**